



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i dosjes: KSC-CC-2023-22

Vendosi: Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese
Gjykatës Vidar Stensland, Kryegjykatës
Gjykatës Rumen Nenkov
Gjykatëse Romina Inkuti, raportuese

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 31 maj 2024

Gjuha: Anglishte

Emri i dosjes: Kërkesë Referuese e Nasim Haradinajt drejtuar Panelit të Gjykatës Kushtetuese

Klasifikimi: Publik

Aktvendim mbi Kërkesën Referuese të Nasim Haradinajt drejtuar Dhomës së
Specializuar të Gjykatës Kushtetuese

Parashtruesit

Nasim Haradinaj

Prokurores së Specializuar

Kimberli P. Uest

I.	PROCEDURA.....	4
A.	KËRKESA REFERUESE DHE KËRKESAT NË LIDHJE ME TË	4
B.	PARASHTRIMET ME SHKRIM DHE SEANCA GJYQËSOR	6
C.	SHQYRTIMI I KËRKESËS REFERUESE.....	7
II.	FAKTET	7
A.	NGJARJET QË ÇUAN NË PROCESIN PENAL KUNDËR PARASHTRUESIT	7
B.	PROCESI GJYQËSOR.....	9
	1. Pengimi i personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare përmes kërcënimit të rëndë.....	10
	2. Frikësimi gjatë procedurës penale	11
	3. Shkelja e fshehtësisë së procedurës përmes zbulimit të paautorizuar të identitetit dhe të dhënave personale të dëshmitarëve të mbrojtur	11
	4. Argumenti mbrojtës lidhur me shtytjen nga ZPS-ja	12
	5. Argumenti mbrojtës i interesit publik.....	13
C.	PROCEDURA E APELIT	15
	1. Pengimi i personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare përmes kërcënimit të rëndë.....	16
	2. Frikësimi gjatë procedurës penale	17
	3. Shkelja e fshehtësisë së procedurës përmes zbulimit të paautorizuar të identitetit dhe të dhënave personale të dëshmitarëve të mbrojtur	18
	4. Argumenti mbrojtës i shtytjes nga ZPS-ja	19
	5. Argumenti mbrojtës i interesit publik.....	20
D.	KËRKESA PËR MBROJTJE TË LIGJSHMËRISË	21
	1. Pengimi i personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare përmes kërcënimit të rëndë.....	21
	2. Frikësimi gjatë procedurës penale	22
	3. Shkelja e fshehtësisë së procedurës përmes zbulimit të paautorizuar të identitetit dhe të dhënave personale të dëshmitarëve të mbrojtur	23
	4. Argumenti mbrojtës i shtytjes nga ZPS-ja	24
	5. Argumenti mbrojtës i interesit publik.....	25
E.	ULJA E DËNIMIT	26
III.	PRETENDIMET PËR SHKELJE	26
IV.	JURIDIKSIONI	27

V.	FUSHËVEPRIMI I RISHQYRTIMIT.....	28
VI.	PRANUESHMËRIA.....	30
A.	PRETENDIMI PËR SHKELJE TË NENIT 33(1) TË KUSHTETUTËS DHE NENIT 7 TË KONVENTËS	31
1.	Parashtrimet	31
2.	Vlerësimi i Dhomës	34
B.	PRETENDIMI PËR SHKELJE TË NENIT 32(1) TË KUSHTETUTËS DHE NENIT 6(1) TË KONVENTËS	43
1.	Parashtrimet	43
2.	Vlerësimi i Dhomës	45
C.	PRETENDIMI PËR SHKELJE TË NENIT 40 TË KUSHTETUTËS DHE NENIT 10 TË KONVENTËS	49
1.	Parashtrimet	49
2.	Vlerësimi i Dhomës	50
D.	PËRFUNDIM.....	52
VII.	THEMELËSIA.....	53
A.	PRETENDIMI PËR SHKELJE TË NENIT 33(1) TË KUSHTETUTËS DHE NENIT 40 TË KONVENTËS	53
1.	Parashtrimet	53
2.	Vlerësimi i Dhomës	54
B.	PËRFUNDIM.....	61
VIII.	KËRKESAT SHOQËRUESE.....	61

Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese

e përbërë nga

Vidar Stensland, Kryegjykatës

Rumen Nenkov, gjykatës

Romina Inkuti, gjykatëse raportuese

pas kuvendimeve nga distanca, lëshon Aktvendimin e mëposhtëm

I. PROCEDURA

A. KËRKESA REFERUESE DHE KËRKESAT SHOQËRUESE

1. Më 20 nëntor 2023, z. Nasim Haradinaj ("Parashtruesi") i paraqiti Kërkesë Referuese Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese ("Dhoma") në bazë të nenit 113(7) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ("Kushtetuta") dhe nenit 49(3) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (përkatësisht, "Ligji" dhe "Kërkesa Referuese").¹ Parashtruesi përfaqësohej nga z. Tobi Kadman, znj. Almudena Bernabeu dhe z. Xhon Kabën.

2. Në Kërkesën Referuese, Parashtruesi u ankua për shkeljen e të drejtave të tij themelore sipas neneve 33(1), 31(2) dhe 40 të Kushtetutës dhe neneve 7, 6(1) dhe 10 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut ("Konventa") në lidhje me procesin penal kundër tij, i cili u zhvillua para Dhomave të Specializuara ("DHS").²

3. Më 22 nëntor 2023, Kryetarja e DHS-së, në bazë të nenit 33(3) të Ligjit caktoi Panelin e lartpërmendur për të vendosur mbi Kërkesën Referuese.³

¹ KSC-CC-2023-22, F00001, Kërkesë Referuese e Haradinajt drejtuar Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, publik, 20 nëntor 2023, me Shtojcën 1, publike.

² Kërkesa Referuese, para. 2, 4-15, 28-83.

³ KSC-CC-2023-22, F00002, Vendim për Caktimin e Gjykatësve të Panelit të Gjykatës Kushtetuese, publik, 22 nëntor 2023. Lidhur me vendin e zhvillimit të procedurave *shih* KSC-CC-2019-06, F00001, Kërkesë për Ndryshimin e Vendit të Zhvillimit të Procedurës në lidhje me Referimet e Parashtruara në përputhje me Nenin 49 të Ligjit, publik, 18 janar 2019; F00002, Vendim për Vendin e Zhvillimit të Procedurave para Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, publik, 22 janar 2019.

4. Më 27 nëntor 2023, Dhoma, në bazë të nenit 20 të Ligjit dhe rregullës 5 të Rregullores së Punës për Dhomën e Specializuar të Gjykatës Kushtetuese ("Rregullorja e DHSGJK-së"), vendosi se gjuha e punës e procedurave do të ishte anglishtja.⁴ Ndër të tjera, Dhoma gjithashtu vendosi të ftonte Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("ZPS"), në qoftë se dëshironte, të dorëzonte parashtrime me shkrim në përgjigje të Kërkesës Referuese dhe Parashtruesin, në qoftë se dëshironte, të dorëzonte parashtrime me shkrim në kundërpërgjigje.⁵

5. Më 27 dhjetor 2023, Parashtruesi i dorëzoi Dhomës një kërkesë për Pranimin e Provës të ankesës së një sinjalizuesi, të paraqitur në një shtojcë konfidenciale ("Kërkesa e Parashtruesit për Pranim të një Prove").⁶

6. Më 5 janar 2024, ZPS-ja njoftoi Dhomën se synonte t'i përgjigjej Kërkesës së Parashtruesit për Pranimin e Provës së bashku me parashtrimet me shkrim mbi Kërkesën Referuese ("Njoftimi i ZPS-së").⁷

7. Më 8 janar 2024, Parashtruesi i paraqiti Dhomës një kërkesë me të cilën i kërkoi të bënte konstatim se Njoftimi i ZPS-së nuk kishte fuqi ligjore ("Kërkesa e Parashtruesit lidhur me Njoftimin e ZPS-së").⁸ Në lidhje me këtë, Parashtruesi pretendoi se, sipas rregullës 1(2) të Rregullores së DHSGJK-së dhe rregullës 76 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), ZPS-ja, ishte e autorizuar që ose të paraqiste përgjigje brenda dhjetë (10) ditësh nga Kërkesa e Parashtruesit për Pranimin e Provës, ose të dorëzonte në

⁴ KSC-CC-2023-22, F00003, Vendim mbi Gjuhën e Punës, Parashtrimet me Shkrim dhe Versionin e Redaktuar Publik të Kërkesës Referuese, publik, 27 nëntor 2023 ("Vendimi mbi Gjuhën e Punës dhe Parashtrimet me Shkrim"), para. 4 dhe Vendimi, para. 1.

⁵ Vendimi mbi Gjuhën e Punës dhe Parashtrimet me Shkrim, para. 5 dhe Vendimi, para. 2-3.

⁶ KSC-CC-2023-22, F00005, Kërkesë Konfidenciale për Pranimin e Ankesës së një Sinjalizuesi, konfidenciale, 22 dhjetor 2023, me Shtojcën 1, konfidenciale. Ndonëse ballina mban datën 22 dhjetor 2023, ajo u dorëzua më 27 dhjetor 2023. Versioni i redaktuar publik i parashtrimit kryesor u dorëzua më 28 dhjetor 2023, F00005/RED.

⁷ KSC-CC-2023-22, F00006, Njoftim në lidhje me Parashtrimin KSC-CC-2023-22/F00005, publik, 5 janar 2024.

⁸ KSC-CC-2023-22, F00007, Kërkesë për Njoftim në lidhje me Parashtrimin KSC-CC-2023-22/F00005, publike, 8 janar 2024.

kohë një kërkesë për zgjatje të afatit, për t'i lënë Dhomës kohë të mjaftueshme për të marrë vendim mbi të përpara përfundimit të afatit.⁹

8. Më 11 janar 2024, Dhoma lëshoi urdhër me të cilin e lejoi ZPS-në t'i përgjigjej Kërkesës së Parashtruesit për Pranimin e Provës së bashku me parashtrimet me shkrim të ZPS-së lidhur me Kërkesën Referuese dhe ftoi Parashtruesin, në qoftë se dëshironte, t'i kundërpërgjigjej përgjigjes së ZPS-së së bashku me kundërpërgjigjen e tij ndaj parashtrimeve me shkrim të ZPS-së lidhur me Kërkesën Referuese.¹⁰ Dhoma gjithashtu informoi Parashtruesin dhe ZPS-në se do ta shqyrtonte Kërkesën e Parashtruesit lidhur me Njoftimin e ZPS-së pasi të merrte parashtrimet me shkrim.¹¹

B. PARASHTRIMET ME SHKRIM DHE SEANCA GJYQËSOR

9. Më 22 janar 2024, ZPS-ja dorëzoi parashtrime me shkrim në lidhje me Kërkesën Referuese.¹²

10. Më 12 shkurt 2024, Parashtruesi dorëzoi parashtrime me shkrim në kundërpërgjigje ndaj ZPS-së.¹³

11. Sa i përket kërkesës alternative të Parashtruesit për të planifikuar një seancë gjyqësore,¹⁴ fillimisht, Dhoma vëren se ZPS-ja i referohet diskrecionit të Dhomës lidhur me domosdoshmërinë e kësaj seance.¹⁵ Në këtë aspekt, Dhoma rikujton se, sipas rregullës 15(4) të Rregullores së DHSGJK-së, pas përfundimit të afateve për dorëzimin

⁹ Kërkesa e Parashtruesit për Pranimin e një Prove, para. 10-11.

¹⁰ KSC-CC-2023-22, F00008, Urdhër mbi Afatet për Dorëzimin e Parashtrimeve, publik, 11 janar 2024 ("Urdhri për Parashtrimet"), para. 6 dhe Vendimi, para. 1-2.

¹¹ Urdhri për Parashtrimet, para. 6 dhe Vendimi, para. 4.

¹² KSC-CC-2023-22, F00009, Përgjigje e Prokurorisë ndaj Kërkesës Referuese të Mbrojtjes së Haradinajt drejtuar Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, publike, 22 janar 2024, me Shtojcat 1-2, publike ("Parashtrimet e ZPS-së").

¹³ KSC-CC-2023-22, F00010, Kundërpërgjigje e Prokurorisë ndaj Kërkesës Referuese të Mbrojtjes së Haradinajt drejtuar Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, publike, 10 shkurt 2024 ("Parashtrimet e Parashtruesit të Kërkesës"), me Shtojcën 1, publike. Ndonëse ballina mban datën 10 shkurt 2024, ajo u dorëzua më 12 shkurt 2024.

¹⁴ Kërkesa Referuese, para. 3, 85.

¹⁵ Parashtrimet e ZPS-së, para 16.

e parashtrimeve me shkrim, Dhoma merr vendim mbi bazën e parashtrimeve me shkrim, përveç nëse mbajtja e seancës gjyqësore është në interes të administrimit të duhur të drejtësisë. Duke pasur parasysh rrethanat konkrete të kësaj Kërkesë Referuese, Dhoma mendon se seanca gjyqësore nuk është e nevojshme.

C. SHQYRTIMI I KËRKESËS REFERUESE

12. Dhoma tani do të shqyrtojë Kërkesën Referuese bazuar në Kërkesën Referuese dhe parashtrimet me shkrim të lartpërmendura nga ZPS-ja dhe Parashtruesi. Ky aktgjykim u referohet fakteve të çështjes dhe parashtrimeve të ZPS-së dhe të Parashtruesit që janë relevante për vlerësimin e Kërkesës Referuese.

II. FAKTET

A. NGJARJET QË ÇUAN NË PROCESIN PENAL KUNDËR PARASHTRUESIT

13. Gjatë një periudhe trejavore nga 7 shtatori deri më 25 shtator 2020, z. Hysni Gucati ("z. Gucati") dhe Parashtruesi, në atë kohë përkatësisht kryetar dhe nënkryetar të Organizatës së Veteranëve të Luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ("OVL-UÇK"), morën, nga burime të panjohura, tri grupe dokumentesh që përmbanin informacion konfidencial dhe jopublik që lidhej me punën e Task Forcës Hetimore Speciale ("TFHS") dhe të ZPS-së. Ky material u dorëzua në Prishtinë në zyrat e OVL-UÇK-së më 7 shtator, 16 shtator dhe 22 shtator 2020.¹⁶

14. Pas çdo dorëzimi, z. Gucati dhe Parashtruesi organizuan dhe mbajtën konferencë për shtyp ku diskutuan dhe u vunë në dispozicion gazetarëve secilin prej tri grupeve të dokumenteve.¹⁷ Në të njëjtën kohë, z. Gucati dhe Parashtruesi, individualisht ose së bashku, dhanë një numër intervistash në media në lidhje me këto

¹⁶ KSC-BC-2020-07, F00611/RED, Version i Redaktuar Publik i Aktgjykimit, publik, 18 maj 2022, ("Aktgjykimi"), para. 204, 207-210, 243-244, 275, me Shtojcat 1-3, publike.

¹⁷ Aktgjykimi, para. 205, 212-221, 247-251, 277-283.

materiale, bënë komente për materialet dhe ripublikuan artikuj në mediat sociale në lidhje me to.¹⁸

15. Gjatë të njëjtës periudhë trejavore, Paneli i përbërë prej Gjykatësit të Vetëm urdhëroi në mënyrë të përsëritur OVL-UÇK-në dhe çdo përfaqësues, anëtar, ose person që vepronte në emër të saj, ndër të tjera, që të mos incizonin, kopjonin në asnjë lloj mënyre dhe të mos shpërndanin më tej me asnjë mjet komunikimi dokumentet e dorëzuara në zyrat e OVL-UÇK-së apo përmbajtjen e tyre, pa autorizimin e ZPS-së ose të Gjykatësit të Vetëm. Gjykatësi i Vetëm gjithashtu paralajmëroi se shkelja e këtyre urdhrave mund të përbëjë vepër penale sipas Kodit Penal të Kosovës të vitit 2019, Kodi nr. 06/L-074 ("KPK"), në bazë të nenit 15(2) të Ligjit.¹⁹

16. Më 24 shtator 2020, Gjykatësi i Vetëm lëshoi fletarrestime dhe urdhra për transferimin e z. Gucati dhe të Parashtruesit.²⁰ Më 25 dhe 26 shtator 2020, z. Gucati dhe Parashtruesi u arrestuan në Kosovë dhe u transferuan në objektin e paraburgimit të DHS-së në Hagë.²¹

17. Më 11 dhjetor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konfirmoi Aktakuzën e paraqitur nga ZPS-ja kundër z. Gucati dhe Parashtruesit, ku ndaj tyre u ngritën dy akuza për vepra penale kundër rendit publik sipas nenit 401(1) dhe (5), dhe 401(2)-(3) të KPK-së, si dhe katër akuza për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë dhe administratës publike sipas neneve 387, 388(1), 392(1) dhe 392(2)-(3) të KPK-së, të cilat pretendohet se u kryen së paku midis 7 shtatorit 2020 dhe 25 shtatorit 2020, të

¹⁸ Aktgjykimi, para. 206, 222-224, 234, 237, 239-241, 253-255, 259-264, 265, 268-274, 284, 286-290, 293-296, 298.

¹⁹ KSC-BC-2020-07, F00005, Vendim URGJENT që Autorizon Sekuestrim, publik, 7 shtator 2020, para. 21, 25; F00007, Vendim për Autorizimin e Sekuestrimit, publik, 17 shtator 2020, para. 21, 25; F00017/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi kërkesën e Prokurorit të Specializuar për Urdhër lidhur me Dokumente Jopublike dhe Konfidenciale, publik, 25 shtator 2020, para. 10.

²⁰ *Shih* KSC-BC-2020-07, F00012/A03/COR/RED, Version i Redaktuar Publik i Versionit të Korrigjuar të Fletarrestimit për Nasim Haradinajn, publik, 24 shtator 2020; F00012/A04/RED, Version i Redaktuar Publik i Urdhrit për Transferim në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara, publik, 24 shtator 2020.

²¹ *Shih* KSC-BC-2020-07, F00016, Njoftim i Arrestimit sipas Rregullës 55(4), publik, 25 shtator 2020; F00020, Njoftim për Pranimin e Nasim Haradinajt në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara, publik, 26 shtator 2020.

zbatueshme në bazë të nenit 15(2) të Ligjit.²²

18. Më 23 qershor 2021, pas vendimit të Panelit të Gjykatës së Apelit, i cili konstatoi se Aktakuza nuk ishte konkrete,²³ Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëroi ZPS-në të parashtronte versionin e korrigjuar të Aktakuzës.²⁴ Më 5 korrik 2021, ZPS-ja dorëzoi Aktakuzën e Korrigjuar.²⁵

19. Më 16 korrik 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ia kaloi dosjen e çështjes gjyqësore Trupit Gjykues.²⁶

B. PROCESI GJYQËSOR

20. Më 18 maj 2022, Trupi Gjykues shqiptoi Aktgjykimin, me të cilin i shpalli Parashtruesin dhe z. Gucati, i bashkëpandehuri i tij, fajtorë për pesë pika të Aktakuzës, konkretisht (i) pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare përmes kërcënimit të rëndë, sipas nenit 401(1) dhe (5) të KPK-së; (ii) pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare nëpërmjet pjesëmarrjes në veprimin e përbashkët të një grupi, sipas nenit 401(2) dhe (5) të KPK-së; (iii) frikësim gjatë procedurës penale, sipas nenit 387 të KPK-së; (iv) shkelje të fshehtësisë së procedurës përmes zbulimit të paautorizuar të informacionit të mbrojtur, sipas nenit 392(1) të KPK-së; si edhe (v) shkelje të fshehtësisë së procedurës përmes zbulimit të paautorizuar të identitetit dhe të dhënave personale të dëshmitarëve të mbrojtur, sipas nenit 392(2)-(3) të KPK-së.²⁷ Trupi Gjykues i konstatoi Parashtruesin dhe z. Gucati të

²² KSC-BC-2020-07, F00074/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Konfirmimin e Aktakuzës, publik, 11 dhjetor 2020, para. 3, 103, 109, 113, 117, 121, 125, 155(a)(i)-(vi). Aktakuza e konfirmuar e ndryshuar më tej u dorëzua më 14 dhjetor 2020, *shih* KSC-BC-2020-07, F00075/A02, Aktakuza e Redaktuar, publike, 14 dhjetor 2020.

²³ *Shih* KSC-BC-2020-07, IA004-F00007, Vendim mbi Apelet e Mbrojtjes kundër Vendimit mbi Mocionet Paraprake, publik, 23 qershor 2021.

²⁴ KSC-BC-2020-07, F00244, Urdhër për Parashtrimin e Aktakuzës së Korrigjuar dhe Kalendarit të Rishikuar për Herë të Dytë të Pjesës së Mbetur të Procedurës Paraprake, publik, 23 qershor 2021.

²⁵ KSC-BC-2020-07, F00251/A02, Aktakuza e Redaktuar, publike, 5 korrik 2021. Aktakuza me më pak redaktime u dorëzua më 4 tetor 2021, F00251/A01/RED.

²⁶ KSC-BC-2020-07, F00265, Vendim për Kalimin e Dosjes së Çështjes Trupit Gjykues II, publik, 16 korrik 2021.

²⁷ Aktgjykimi, para. 1012, 1015.

pafajshëm për një pikë të Aktakuzës, konkretisht për veprën penale të hakmarrjes sipas nenit 388 të KPK-së.²⁸

21. Parashtruesi dhe z. Gucati u dënuan të dy me katër vjet e gjysmë burgim, duke llogaritur kohën e kaluar në paraburgim, dhe me një gjobë prej 100 eurosh secili.²⁹

1. Pengimi i personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare përmes kërcënimit të rëndë

22. Gjatë gjykimit, Parashtruesi bëri një numër parashtrimesh në lidhje me interpretimin e veprimit të fajshëm të veprës penale të pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare sipas nenit 401(1) të KPK-së,³⁰ i cili përcakton se:

Kushdo që me forcë apo kanosje serioze, pengon ose tenton të pengojë personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare, ose duke përdorur mjetet e njëjta, e detyron atë të kryejë detyrën zyrtare, dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.

23. Parashtruesi, ndër të tjera, argumentoi se, neni 401(1) i KPK-së kërkon që përdorimi i forcës ose kërcënimit të rëndë të drejtohen kundër personit zyrtar.³¹ Sidoqoftë, Trupi Gjykses konstatoi se në kontekstin e nenit 401(1) të KPK-së “kërcërimi i rëndë” mund të mos drejtohet vetëm kundër “një personi zyrtar”, që mund të përfshijë zyrtarë të DHS-së dhe ZPS-së, si gjykatës, prokuror apo hetues, por edhe kundër një personi apo objekti tjetër, në qoftë se ka për qëllim pengimin e kryerjes së detyrave zyrtare ose të funksioneve të personit zyrtar.³²

²⁸ Aktgjykimi para. 1013, 1016.

²⁹ Aktgjykimi, para. 1014, 1017.

³⁰ Aktgjykimi, para. 142.

³¹ KSC-BC-2020-07, F00342, Parashtrime të Mbrojtjes në lidhje me Elementet e Veprave Penale dhe Format e Përgjegjësisë Penale, publike, 30 shtator 2021 (“Parashtrimet e Haradinajt në lidhje me Elementet e Veprave Penale dhe Përgjegjësinë Penale”), para. 34-35; F00440/RED, Version i Redaktuar Publik i Mocionit të Mbrojtjes për ‘Rrëzimin e Akuzave’ sipas Rregullës 130, publik, 27 nëntor 2021 (“Mocioni i Haradinajt sipas Rregullës 130”), para. 11. *Shih gjithashtu* KSC-BC-2020-07, F00345, Parashtrime të Mëtejshme me Shkrim në lidhje me Elementet e Veprave Penale dhe Format e Përgjegjësisë Penale, publike, 30 shtator 2021 (“Parashtrimet e Gucatit në lidhje me Elementet e Veprave Penale dhe Format e Përgjegjësisë Penale”), para. 3-7; F00439/RED, Version i Redaktuar Publik i Mocionit për Rrëzimin e Akuzave në Përputhje me Rregullën 130, publik, 13 dhjetor 2021 (origjinali u dorëzua më 17 nëntor 2021) (“Mocioni i Gucatit sipas Rregullës 130”), para. 28.

³² Aktgjykimi, para. 146.

2. Frikësimi gjatë procedurës penale

24. Parashtruesi gjithashtu paraqiti parashtrime lidhur me interpretimin e veprimit të fajshëm për veprën penale të frikësimit gjatë procedurës penale sipas nenit 387 të KPK-së,³³ që përcakton se:

Kushdo që përdor forcën apo kanosjen serioze apo ndonjë mënyrë tjetër të detyrimit, premtion dhuratë apo ndonjë përfitim tjetër për të nxitur personin tjetër të përmbahet nga dhënia e deklaratës ose për të dhënë deklaratë të rreme, ose për të mos dhënë informacione të vërteta pranë organeve policore, prokurorit apo gjyqtarit, kur informacionet e tilla ndërlidhen me pengimin e procedurës penale, dënohet me gjobë deri në njëqind e njëzet e pesëmijë (125.000) euro dhe me burgim prej dy (2) deri në dhjetë (10) vjet.

25. Parashtruesi, ndër të tjera, argumentoi se informacioni që duhej të dorëzohej, por nuk u dorëzua si pasojë e përdorimit të forcës ose kërcënimit të rëndë, duhet të jetë i lidhur me pengimin e procedurës penale.³⁴ Trupi Gjykues konstatoi se fraza “kur informacione të tilla ndërlidhen me pengimin e procedurës penale” përshkruan vetëm alternativën e tretë të dispozitës, konkretisht personi që nuk “jep informacione të vërteta pranë organeve policore, prokurorit apo gjyqtarit”.³⁵ Rrjedhimisht, Trupi Gjykues gjykoi se frikësimi sipas nenit 387 të KPK-së mund të drejtohet kundër çdo personi që i kishte dhënë ose kishte të ngjarë t’i jepte deklaratë apo informacion lidhur me procedurën penale policisë, prokurorit ose gjykatësit, dhe jo vetëm kundër atyre që kishin informacion lidhur me pengimin e procedurës penale.³⁶

3. Shkelja e fshehtësisë së procedurës përmes zbulimit të paautorizuar të identitetit dhe të dhënave personale të dëshmitarëve të mbrojtur

26. Po ashtu, Parashtruesi bëri parashtrime lidhur me interpretimin e veprimit të fajshëm të veprës penale të shkeljes së fshehtësisë së procedurës përmes zbulimit të

³³ Aktgjykimi, para. 110.

³⁴ Parashtrimet e Haradinajt në lidhje me Elementet e Veprave Penale dhe Përgjegjësinë Penale, para. 26; Mocioni i Haradinajt sipas Rregullës 130, para. 11. *Shih gjithashtu* Parashtrimet e Gucatit në lidhje me Elementet e Veprave Penale dhe Format e Përgjegjësisë Penale, para. 34; Mocioni i Gucatit sipas Rregullës 130, para. 58-59.

³⁵ Aktgjykimi, para. 114.

³⁶ Aktgjykimi, para. 113-114.

paautorizuar të identitetit dhe të dhënave personale të dëshmitarëve të mbrojtur sipas nenit 392(2) të KPK-së,³⁷ që përcakton se:

Kushdo që pa autorizim zbulon të dhëna për identitetin apo të dhënat personale të personit të mbrojtur në procedurë penale apo në programin e veçantë të mbrojtjes, dënohet me burgim deri në tre (3) vjet.

27. Parashtruesi, ndër të tjera, argumentoi se informacioni i zbuluar duhet të ketë lidhje me një person të marrë në mbrojtje me anë të një mase të posaçme mbrojtjeje në procedurën penale, ose një programi të posaçëm mbrojtjeje.³⁸ Trupi Gjykses konstatoi se “personi i mbrojtur në procedurë penale”, sipas kuptimit të nenit 392(2) të KPK-së, mund t’i referohet jo vetëm çdo personi që ligji e konsideron të mbrojtur, ose atyre për të cilët është dhënë urdhër apo miratuar masë mbrojtëse në procedurë penale nga një panel kompetent apo ZPS-ja por edhe, në përputhje me nenin 62 të Ligjit, çdo personi identiteti apo të dhënat personale të të cilit gjenden në dokumentet ose materialet e DHS-së ose ZPS-së, nxjerrja e të cilave nuk është autorizuar.³⁹

4. Argumenti mbrojtës lidhur me shtytjen nga ZPS-ja

28. Gjatë gjykimit, Parashtruesi përmendi një sërë arsyes për sjelljen e tij, ndër të tjera, se ai ishte objekt i shtytjes nga ZPS-ja për kryerjen e veprave penale të paraqitura në Aktakuzë.⁴⁰ Trupi Gjykses vuri në dukje se, as në Ligj, as në Rregullore, as në KPK nuk përmendet shprehimisht shtytja për kryerjen e veprës penale si arsye që përjashton përgjegjësinë penale. Ligji dhe Kushtetuta kërkojnë që DHS-ja të respektojë dhe zbatojë standardet e njohura ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, përfshirë ato

³⁷ Aktgjykimi, para. 90.

³⁸ Parashtrimet e Haradinajt në lidhje me Elementet e Veprave Penale dhe Përgjegjësinë Penale, para. 14-15; Mocioni i Haradinajt sipas Rregullës 130, para. 11. *Shih gjithashtu* Parashtrimet e Gucatit në lidhje me Elementet e Veprave Penale dhe Format e Përgjegjësisë Penale, para. 10-11; Mocioni i Gucatit sipas Rregullës 130, para. 88-89; Mocioni i Haradinajt sipas Rregullës 130, para. 11.

³⁹ Aktgjykimi, para. 95.

⁴⁰ KSC-BC-2020-07, F00260/RED, Parashtrim i Redaktuar Publik i Dosjes Paraprake të Përkohshme të Mbrojtjes së Nasim Haradinajt, publik, 12 korrik 2021 (“Dosja Paraprake e Haradinajt”), para. 277(a), 278-280; F00566/RED, Version i Redaktuar Publik i Dosjes Gjyqësore Përfundimtare në Emër të Nasim Haradinajt, publik, 11 mars 2022 (origjinali u dorëzua më 3 mars 2022) (“Dosja Gjyqësore e Haradinajt”), para. 392-440.

të Konventës.⁴¹ Duke rikujtuar jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ("GJEDNJ") lidhur me shtytjen për kryerjen e veprës penale,⁴² Trupi Gjykues vuri re se, ndonëse shtytja për kryerjen e veprës penale nuk përbën argument mbrojtës formal ndaj akuzave, ajo përcakton kriteret procedurale që duhet të zbatohen nga gjykatat dhe autoritetet prokuroriale për të garantuar drejtësinë e procedurës penale në një çështje gjyqësore ku është ngritur pretendimi i shtytjes për kryerje të veprës penale.⁴³ Rrjedhimisht, Trupi Gjykues vendosi të trajtojë pretendimin e Parashtruesit për shtytje për kryerjen e veprës penale.⁴⁴

29. Trupi Gjykues, ndër të tjera, bëri të ditur se një nga kushtet në të cilat zbatohet neni 6 i Konventës në rastet e shtytjes për kryerjen e veprës penale është se i takon prokurorisë të vërtetojë se nuk ka pasur shtytje për kryerjen e veprës penale, përveç nëse pretendimet e të akuzuarit janë tërësisht të pagjasa.⁴⁵ Gjithashtu, Trupi Gjykues vuri në dukje se, në qoftë se ngrihet pretendim për shtytje dhe ka prova *prima facie* për të, gjykata duhet të shqyrtojë faktet e çështjes dhe të ndërmarrë hapat e nevojshëm për të zbuluar nëse ka pasur të tillë.⁴⁶ Në vlerësimin e pretendimit të Parashtruesit për shtytje për kryerjen e veprave penale, Trupi Gjykues konstatoi se nuk kishte bazë të arsyeshme për të arritur në përfundimin se ai ishte shtyrë të kryente vepra penale nga zyrtarë të ZPS-së ose nga ndonjë person tjetër që vepronte sipas udhëzimeve, ose ishte nën kontrollin e ZPS-së.⁴⁷ Trupi Gjykues gjykoi se pretendimi i shtytjes për kryerjen e veprave penale ishte krejtësisht i pagjasë dhe i pabazuar.⁴⁸

5. Argumenti mbrojtës i interesit publik

⁴¹ Aktgjykimi, para. 800, 835-836.

⁴² Aktgjykimi, para. 836-838.

⁴³ Aktgjykimi, para. 839.

⁴⁴ Aktgjykimi, para. 854-890.

⁴⁵ Aktgjykimi, para 837.

⁴⁶ Aktgjykimi, para. 837.

⁴⁷ Aktgjykimi, para. 889.

⁴⁸ Aktgjykimi, para. 890.

30. Parashtruesi gjithashtu pretendoi se çdo zbulim i paautorizuar i informacionit që u konstatua se ishte bërë prej tij, përligjej prej faktorëve të interesit publik në lidhje me bashkëpunimin ndërmjet Serbisë dhe TFHS-së/ZPS-së.⁴⁹ Ai pretendoi se argumenti mbrojtës i interesit publik përbënte mbrojtje kundër akuzave të paraqitura në Aktakuzë.⁵⁰ Trupi Gjykses theksoi se as në Ligj, as në Rregullore, as në KPK nuk përmendet shprehimisht interesi publik si arsye që përjashton përgjegjësinë penale. Ligji dhe Kushtetuta kërkojnë që DHS-ja të respektojë dhe të zbatojë standardet e njohura ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, përfshirë ato të përcaktuara në Konventë.⁵¹ Në këtë aspekt, Trupi Gjykses rikujtoi se neni 40 i Kushtetutës dhe neni 10 i Konventës garantojnë lirinë e shprehjes, dhe se GJEDNJ-ja ka përcaktuar se ushtrimi i lirisë së shprehjes në funksion të interesit publik përligj mbrojtje të veçantë.⁵² Rrjedhimisht, Trupi Gjykses vendosi të trajtojë pretendimin e Parashtruesit lidhur me interesin publik në kontekstin e lirisë së shprehjes dhe si arsye e mundshme që mund të ndikonte në përgjegjësinë penale individuale të tij.⁵³

31. Duke vënë në dukje përkufizimin e interesit publik në nenin 200(4) të KPK-së, si dhe në jurisprudencën relevante të GJEDGJ-së, Trupi Gjykses e përkufizoi nocionin e interesit publik në kontekstin e bashkëpunimit të TFHS-së/ZPS-së me Serbinë si:

I kufizuar vetëm në provat që do të sugjeronin se një pjesë e materialit që pretendohet të jetë nxjerrë nga [Parashtruesi] përmban tregues të veprimeve të papërshtatshme që kanë ndodhur në kontekst të bashkëpunimit midis Republikës së Serbisë (ose zyrtarëve të saj) dhe TFHS-së/ZPS-së, që do të kishte ndikuar në pavarësinë, paanësinë ose integritetin e hetimeve të TFHS-së/ZPS-së.⁵⁴

32. Në vlerësimin e pretendimit të interesit publik nga Parashtruesi, Trupi Gjykses konstatoi se nuk kishte arsye të besueshme për të arritur në përfundimin se

⁴⁹ Dosja Paraprake e Haradinajt, para. 277(d), 283-298; Dosja Gjyqësore e Haradinajt, para. 19, 131, 391, 441, 443, 477, 491, 497.

⁵⁰ Dosja Paraprake e Haradinajt, para. 277(d), 283-298.

⁵¹ Aktgjykimi, para. 800, 806.

⁵² Aktgjykimi, para. 806.

⁵³ Aktgjykimi, para. 806.

⁵⁴ Aktgjykimi, para. 808.

informacioni i zbuluar prej tij kishte tregues të veprimeve të palejueshme që mund t'u atribuoheshin TFHS-së/ZPS-së.⁵⁵ Gjithashtu, Trupi Gjykses arriti në përfundimin se, edhe po të supozohet se ishte e arsyeshme që Parashtruesi të besonte se informacioni i zbuluar kishte tregues veprimesh të palejueshme që ndikuan në hetimet e TFHS-së/ZPS-së, veprimet e Parashtruesit shkuan përtej demaskimit të asaj që ai i quante veprime të papërshtatshme në bashkëpunimin e TFHS-së/ZPS-së me Serbinë.⁵⁶ Së fundi, Trupi Gjykses gjykoi se, edhe po të supozohej se veprimet e Parashtruesit u nxitën, të paktën në njëfarë mase, nga faktorë të interesit publik, ndërhyrja në të drejtën e lirisë së shprehjes të Parashtruesit me anë të ndjekjes penale ishte e ligjshme, u bë për mbrojtjen e një numri interesash publike legjitime dhe ishte e domosdoshme në një shoqëri demokratike.⁵⁷ Trupi Gjykses arriti në përfundimin se përgjegjësia penale e Parashtruesit nuk mund të përjashtohej prej faktorëve të interesit publik.⁵⁸

C. PROCEDURA E APELIT

33. Më 2 shkurt 2023, pas apelimit të Aktgjykimit nga z. Gucati dhe Parashtruesi, Paneli i Gjykatës së Apelit konfirmoi shumicën e verdikteve të fajësisë të tyre, prapësoi verdiktin e fajësisë për pengimin e personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare nëpërmjet pjesëmarrjes në veprimin e përbashkët të një grupi.⁵⁹ Duke pasur parasysh këto konstatime, Paneli i Apelit, me shumicë, uli dënimet e dhëna nga Trupi Gjykses nga katër vjet e gjysmë në katër vjet e tre muaj burgim, duke llogaritur kohën e kaluar në paraburgim dhe la në fuqi për z. Gucati dhe Parashtruesin dënimin shtesë me një gjobë prej 100 eurosh secili.⁶⁰

⁵⁵ Aktgjykimi, para. 811-817.

⁵⁶ Aktgjykimi, para. 818-819.

⁵⁷ Aktgjykimi, para. 820-823.

⁵⁸ Aktgjykimi, para. 824.

⁵⁹ KSC-CA-2022-01, F00114, Aktgjykimi i Apelit, 2 shkurt 2023, publik ("Aktgjykimi i Apelit"), para. 442, me Shtojcat 1-2, publike.

⁶⁰ Aktgjykimi i Apelit, para. 442.

1. Pengimi i personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare përmes kërcënimit të rëndë

34. Në apel, Parashtruesi, ndër të tjera, kundërshtoi konstatimet e Trupit Gjykses në lidhje me veprimin e fajshëm mbi të cilin u bazua shpallja fajtor e tij për pengimin e personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare sipas nenit 401(1) dhe (5) të KPK-së.⁶¹ Në veçanti, Parashtruesi pretendoi se përdorimi i forcës ose i kërcënimit të rëndë duhet të drejtohet ndaj personit që kryen detyra zyrtare.⁶² Në këtë aspekt, Parashtruesi parashtroi se teksti i nenit 401(1) të KPK-së nuk përmban formulim që sugjeron se qëllimi i nenit është të parandalojë edhe pengimin e tërthortë të detyrave zyrtare.⁶³

35. Në lidhje me qëllimin e kërcënimit të rëndë, Paneli i Apelit, me shumicë, u pajtua me konstatimin e Trupit Gjykses se në formulimin e kësaj dispozite nuk kërkohet që kërcënimi i rëndë të drejtohet konkretisht kundër personit zyrtar në fjalë.⁶⁴ Paneli i Apelit ishte i mendimit se, për ta përfshirë këtë element, do të duhej që kjo dispozitë të formulohej në mënyrë të tillë ku të kërkohej shprehimisht që përdorimi i forcës ose i kërcënimit të rëndë të drejtoheshin kundër personit zyrtar ose personave zyrtarë.⁶⁵ Në këtë aspekt, Paneli i Apelit gjykoi se Trupi Gjykses me të drejtë e interpretoi nenin 401(1) të KPK-së në përputhje me arsyen e ekzistencës së dispozitës, e cila është të sigurojë mospengimin e kryerjes së detyrave zyrtare, drejtpërdrejt ose tërthorazi.⁶⁶ Paneli i Apelit, me shumicë, konstatoi se nuk kishte asnjë gabim në konstatimin e Trupit Gjykses se vepra penale sipas nenit 401(1) të KPK-së vërtetohet edhe në rastet

⁶¹ Aktgjykimi i Apelit, para. 269.

⁶² KSC-CA-2022-01, F00035/COR2, Version i Korrigjuar më Tej i Dosjes së Apelit të Mbrojtjes së z. Nasim Haradinaj, publik, 2 shtator 2022 (origjinali u dorëzua më 19 shtator 2022) ("Dosja e Apelit të Haradinajt"), para. 173-177, me Shtojcën 1, publike; F00065, Kundërpërgjigje e Ridorëzuar e Haradinajt ndaj Dosjes së Përgjigjes së ZPS-së në lidhje me Dosjen e Apelit të Mbrojtjes, publike, 15 tetor 2022 ("Kundërpërgjigja e Haradinajt në lidhje me Dosjen e Apelit"), para. 46.

⁶³ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 176; Kundërpërgjigja e Haradinajt në lidhje me Dosjen e Apelit, para. 46.

⁶⁴ Aktgjykimi i Apelit, para. 282.

⁶⁵ Aktgjykimi i Apelit, para. 282.

⁶⁶ Aktgjykimi i Apelit, para. 282.

kur kërcënimi i rëndë drejtohet ndaj personave të tjerë, që, në rastin e Parashtruesit, janë ata që i dhanë dëshmi, ose kishin të ngjarë t'i jepnin dëshmi DHS-së ose ZPS-së.⁶⁷

2. Frikësimi gjatë procedurës penale

36. Në një nga pikat e Apelit të paraqitura në Njoftimin për Apel, Parashtruesi parashtroi se Trupi Gjykses bëri gabim juridik në lidhje me nenin 387 të KPK-së kur interpretoi se çfarë përfshihet në frazën “kur informacione të tilla ndërlidhen me pengimin e procedurës penale”.⁶⁸ Sidoqoftë, në Dosjen e Apelit, Parashtruesi dukej se kishte hequr dorë nga kjo pikë e Apelit.⁶⁹ Rrjedhimisht, Paneli i Apelit shqyrtoi vetëm kundërshtimin e z. Gucati lidhur me interpretimin e nenit 387 të KPK-së.⁷⁰

37. Sa i përket kuadrit të cilësimit të lartpërmendur, Paneli i Apelit konstatoi se fraza “informacione të tilla” në nenin 387 të KPK-së i referohet frazës “informacione të vërteta” në alternativën e tretë, konkretisht personit që nuk jep “informacione të vërteta pranë organeve policore, prokurorit apo gjyqtarit”, për shkak të vendit ku është vendosur cilësimi dhe formulimi i tij.⁷¹ Paneli i Apelit gjykoi se fushëveprimi i nenit 387 të KPK-së nuk kufizohej vetëm në përdorimin e forcës ose të kërcënimit të rëndë në lidhje me pengimin e procesit gjyqësor,⁷² dhe, rrjedhimisht, rrëzoi këtë pikë të Apelit.⁷³

⁶⁷ Aktgjykimi i Apelit, para. 282.

⁶⁸ KSC-CA-2022-01, F00029, Njoftim i Ridorëzuar i Mbrojtjes së Haradinajt për Apelimin e Aktgjykimit, publik, 8 korrik 2022, para. 25. Ndonëse ballina mban datën 8 korrik 2022, ai u dorëzua më 10 korrik 2022.

⁶⁹ Aktgjykimi i Apelit, para. 211, poshtëshënimi 460. *Shih gjithashtu* Dosjen e Apelit të Haradinajt.

⁷⁰ KSC-CA-2022-01, F00036/RED, Version i Redaktuar Publik i Dosjes së Apelit të Gucatit, publik, 19 gusht 2022 (“Dosja e Apelit të Gucatit”), para. 10-20, me Shtojcat 1-4, publike. Ndonëse ballina mban datën 19 gusht 2022, origjinali u dorëzua më 22 gusht 2022. *Shih gjithashtu* KSC-CA-2022-01, F00067/RED, Version i Redaktuar Publik i Dosjes së Kundërpërgjigjes të Ridorëzuar prej Gucatit sipas Rregullës 179(3), publik, 17 tetor 2022, para. 16-17, 21.

⁷¹ Aktgjykimi i Apelit, para. 221.

⁷² Aktgjykimi i Apelit, para. 222.

⁷³ Aktgjykimi i Apelit, para. 230.

3. Shkelja e fshehtësisë së procedurës përmes zbulimit të paautorizuar të identitetit dhe të dhënave personale të dëshmitarëve të mbrojtur

38. Në Pikën 22 Apelit të tij, Parashtruesi argumentoi se Trupi Gjykses bëri gabim juridik që konstatoi se “personi i mbrojtur në procedurën penale”, sipas nenit 392(2) të KPK-së, ishte çdo person lidhur me të cilin ekziston kusht ligjor, urdhër ose masë mbrojtëse e lëshuar ose zbatuar në procedurë penale dhe mund të jetë një person identiteti ose të dhënat personale të të cilit gjenden në dokumentet ose materialet e DHS-së ose ZPS-së, nxjerrja e të cilave nuk është autorizuar.⁷⁴ Në mbështetje të këtij argumenti, Parashtruesi iu referua argumenteve të paraqitura në Pikën 4 të Apelit të tij.⁷⁵ Megjithatë, duke qenë se në Pikën 4 kundërshtohet vendimi i Trupit Gjykses për t'i lejuar ZPS-së mosnxjerrjen e materialit që Parashtruesi nxori në mënyrë të paligjshme, në vend të interpretimit të nenit 392(2) të KPK-së, Paneli i Apelit rrëzoi menjëherë Pikën 22 të Apelit të Parashtruesit si të pabazë.⁷⁶

39. Në mënyrë të ngjashme, z. Gucati kundërshtoi konstatimet e Trupit Gjykses lidhur me formulimin “të mbrojtur në procedurë penale” në kuadër të nenit 392(2) të KPK-së.⁷⁷ Në veçanti, ai pretendoi se, në vend të vlerësimit nga Trupi Gjykses si mundësim të “mbrojtjes tërësore”, neni 62(2) i Ligjit u referohet konkretisht mbrojtjeve që “i jepen” një personi, dhe jo thjesht përmendjes së emrit të një individi në një dokument të ZPS-së.⁷⁸ Duke theksuar se argumentet e z. Gucati nuk i referoheshin asnjë pjese të Aktgjykimit dhe se nuk që në gjendje të identifikonte se cilës “mbrojtje tërësore” i referohej, Paneli i Apelit nuk e trajtoi këtë pjesë specifike të pikës së Apelit të z. Gucati në Aktgjykimin e Apelit.⁷⁹

⁷⁴ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 194.

⁷⁵ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 195. *Shih gjithashtu* Kundërpërgjigjen e Haradinajt në lidhje me Dosjen e Apelit, para. 57.

⁷⁶ Aktgjykimi i Apelit, para. 172-173.

⁷⁷ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 217-224, 243.

⁷⁸ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 218.

⁷⁹ Aktgjykimi i Apelit, para. 185.

4. Argumenti mbrojtës i shtytjes nga ZPS-ja

40. Në Apelin e tij, Parashtruesi pretendoi se Trupi Gjykses gaboi që nuk hetoi burimin e rrjedhjes nga ZPS-ja, duke ia kaluar kështu Parashtruesit detyrimin për të mbështetur me prova pretendimet e tij *prima facie* e shtytjes/nxitjes për kryerje të veprës penale. Ai më tej argumentoi se Trupi Gjykses gaboi që shpërfilli ose nuk pranoi prova të cilat tregonin se burimi i rrjedhjes ishte ZPS-ja.⁸⁰ Parashtruesi gjithashtu pretendoi se, sipas mendimit të tij, ai e përmbushi standardin “jo tërësisht i pagjasë” që zbatohet për pretendimet e shtytjes për kryerje të veprës penale.⁸¹

41. Paneli i Apelit vuri në dukje se disa nga pikat e Apelit të Parashtruesit në lidhje me argumentet mbrojtëse, përfshirë atë të shtytjes nga ZPS-ja, kishin një numër mangësish dhe problemesh procedurale që përligjin rrëzimin e menjëhershëm të tyre, gjithsesi, për hir të drejtësisë ndaj Parashtruesit, megjithatë vendosi t’i trajtonte ato argumente të tij që përkonin me argumentet e paraqitura nga z. Gucati.⁸²

42. Fillimisht, Paneli i Apelit përcaktoi se Trupi Gjykses me të drejtë konstatoi faktin se, me kusht që pretendimet e Parashtruesit të mos ishin tërësisht të pagjasa, i takon Prokurorisë të vërtetojë se nuk ka pasur shtytje për kryerje të veprës penale.⁸³ Në këtë aspekt, Paneli i Apelit gjykoi se Parashtruesi dhe z. Gucati keqinterpretuan standardin e zbatueshëm kur argumentuan se standardi “jo tërësisht i pagjasë” është aq i ulët saqë përjashton çdo detyrim për paraqitje të provave, madje edhe në rastin kur është në diskutim përfshirja në çfarëdo mënyre e ZPS-së në kryerjen e veprave penale.⁸⁴ Paneli i Apelit rikujtoi se sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së lidhur me shtytjen për kryerje të veprës penale, duhet që në kryerjen e veprës penale të jenë të përfshirë punonjës të rendit dhe të ligjit – si parakusht ekzistues për diskutime.⁸⁵ Sipas

⁸⁰ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 135-144.

⁸¹ *Shih* KSC-CA-2022-01, Transkripti i seancës së apelit, publik, 1 dhjetor 2022, f. 86, rreshti 12 deri në f. 89, rreshti 25.

⁸² Aktgjykimi i Apelit, para. 314, 356.

⁸³ Aktgjykimi i Apelit, para. 363.

⁸⁴ Aktgjykimi i Apelit, para. 366.

⁸⁵ Aktgjykimi i Apelit, para. 367.

mendimit të Panelit të Apelit, GJEDNJ-ja me qëllim e trajtoi aspektin e përfshirjes së punonjësve të rendit dhe të ligjit në kuadër të standardit “jo tërësisht i pagjasë”.⁸⁶ Rrjedhimisht, Paneli i Apelit rrëzoi pretendimin e Parashtruesit se konstatimet e Trupit Gjykses sipas të cilave Parashtruesi duhej të paraqiste prova *prima facie* për përfshirjen e ZPS-së në kryerjen e veprave penale, ishte përmbysje e gabuar e detyrimit për vërtetimin e shtytjes për kryerje të veprës penale.⁸⁷

5. Argumenti mbrojtës i interesit publik

43. Në Apel, Parashtruesi pretendoi gjithashtu se Trupi Gjykses gaboi që konstatoi se argumenti mbrojtës i interesit publik nuk ekziston në legjislacionin e Kosovës dhe që nuk mori parasysh përfshirjen e burimeve serbe të TFHS-së/ZPS-së në atë që ai iu referua si “regjimin kriminal të Millosheviqit që u dënua nga e gjithë bota”, si edhe qëndrimin që ka mbajtur Serbia në vite ndaj Kosovës.⁸⁸ Parashtruesi gjithashtu argumentoi se veprimet që janë në përputhje me të drejtën e lirisë së shprehjes të garantuar nga Kushtetuta dhe Konventa nuk mund të konsiderohen veprime kriminale.⁸⁹

44. Në mënyrë të ngjashme me Trupin Gjykses, Paneli i Apelit konstatoi se argumenti mbrojtës i interesit publik, në qoftë se provohet në lidhje me veprat penale relevante, nuk nënkupton se vepra penale nuk është kryer, por do të shërbente si arsye për përjashtimin e përgjegjësisë penale individuale.⁹⁰ Gjithashtu, Paneli i Apelit konstatoi se, duke qenë se e shqyrtoi shprehimisht nocionin e interesit publik sipas nenit 200(2) të KPK-së, krahas nenit 40 të Kushtetutës dhe nenit 10 të Konventës, Trupi Gjykses nuk gaboi që konstatoi se argumenti mbrojtës i interesit publik nuk ekzistonte në legjislacionin e Kosovës.⁹¹ Gjithashtu, Paneli i Apelit konstatoi se Trupi Gjykses

⁸⁶ Aktgjykimi i Apelit, para. 368.

⁸⁷ Aktgjykimi i Apelit, para. 369.

⁸⁸ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 108, 113-114.

⁸⁹ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 110.

⁹⁰ Aktgjykimi i Apelit, para. 321-323.

⁹¹ Aktgjykimi i Apelit, para. 334.

vlerësoi si duhej nëse interesi publik i pretenduar nga Parashtruesi do të kishte më shumë peshë se interesi i mosnxjerrjes së informacionit konfidencial.⁹²

45. Së fundi, duke pasur parasysh konstatimin e lartpërmendur dhe duke qenë se argumentet e Parashtruesit lidhur me përfshirjen e Serbisë në punën dhe hetimet e TFHS-së/ZPS-së ishin përgjithësisht të pambështetura, Paneli i Apelit vendosi që mos t'i trajtonte argumentet e mbetura të Parashtruesit.⁹³ Gjithsesi, Paneli i Apelit rikujtoi se, ndonëse Parashtruesi pretendoi se Trupi Gjykses dëmtoi këtë aspekt të mbrojtjes, gjatë gjyqimit ai nuk e kundërshtoi përkufizimin e përdorur nga Trupi Gjykses për nocionin e interesit publik në kontekstin e bashkëpunimit të TFHS-së/ZPS-së me Serbinë.⁹⁴ Rrjedhimisht, Paneli i Apelit rrëzoi apelin e Parashtruesit në lidhje me gabimet në konstatimet e Trupit Gjykses për argumentin mbrojtës të interesit publik.⁹⁵

D. KËRKESA PËR MBROJTJE TË LIGJSHMËRISË

46. Më 18 shtator 2023, Paneli i Gjykatës Supreme rrëzoi, tërësisht, kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitura nga z. Gucati dhe Parashtruesi.⁹⁶

1. Pengimi i personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare përmes kërcënimit të rëndë

47. Në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë Parashtruesi parashtroi, ndër të tjera, se Trupi Gjykses dhe Paneli i Apelit shkelën të drejtën penale duke zgjeruar në mënyrë të palejueshme fushëveprimin e nenit 401(1) të KPK-së me përfshirjen e kërcënimit të rëndë ndaj personave të tretë dhe jo ndaj një personi zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare.⁹⁷ Parashtruesi gjithashtu pretendoi se interpretimi i nenit 401(1) të KPK-së,

⁹² Aktgjykimi i Apelit, para. 337.

⁹³ Aktgjykimi i Apelit, para. 338.

⁹⁴ Aktgjykimi i Apelit, para. 339.

⁹⁵ Aktgjykimi i Apelit, para. 340.

⁹⁶ KSC-SC-2023-01, F00021, Vendim mbi Kërkesën për Mbrojtje të Ligjshmërisë, publik, 18 shtator 2023 ("Vendimi për Mbrojtje të Ligjshmërisë").

⁹⁷ KSC-SC-2023-01, F00009, Kërkesë e Ridorëzuar e Mbrojtjes së Haradinajt për Mbrojtje të Ligjshmërisë, publike, 9 maj 2023 ("Kërkesa e Haradinajt për Mbrojtje të Ligjshmërisë"), para. 2(a), 14-16, 18, 20. *Shih gjithashtu* KSC-SC-2023-01, F00019, Kundërpërgjigje e Haradinajt ndaj Përgjigjes Përmbledhëse të

sipas konstatimit të Trupit Gjykses dhe shumicës së Panelit të Apelit, shkelte parimin e ligjshmërisë dhe argumentoi se në gjykim nuk u paraqit asnjë provë që të tregonte se ai kërcënoi rëndë një person zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare.⁹⁸

48. Në vlerësimin e themelësisë së ankesës së Parashtruesit, Paneli i Gjykatës Supreme nuk gjykoi se interpretimi i nenit 401(1) të KPK-së nga Trupi Gjykses, që u konfirmua edhe nga Paneli i Apelit, ishte tepër i gjerë, ose se shkelte parimin e ligjshmërisë të përcaktuar në nenin 33(1) të Kushtetutës.⁹⁹ Në veçanti, Paneli i Gjykatës Supreme gjykoi se përgjegjësia e gjykatësve për të interpretuar legjislacionin në përputhje me objektin dhe qëllimin e tij dhe me rrethanat e një çështjeje gjyqësore konkrete, është pranuar jo vetëm nga GJEDNJ-ja, por edhe në kornizën kushtetuese të zbatueshme në DHS, me kusht që interpretimi i ri që rezulton të jetë në përputhje me thelbin e veprës penale dhe mund të parashikohej në mënyrë të arsyeshme.¹⁰⁰ Rrjedhimisht, Paneli i Gjykatës Supreme rrëzoi ankesën e Parashtruesit.¹⁰¹

2. Frikësimi gjatë procedurës penale

49. Parashtruesi gjithashtu parashtroi se fraza “kur informacione të tilla ndërliken me pengimin e procedurës penale” cilëson të gjitha veprimet dhe mosveprimet alternative të përmendura në nenin 387 të KPK-së dhe jo vetëm alternativën e tretë, sikurse konstatoi Trupi Gjykses dhe u konfirmua nga Paneli i Apelit. Sipas mendimit të Parashtruesit, interpretimi i paneleve ishte i gabuar dhe përbënte shkelje të së drejtës penale.¹⁰²

50. Duke theksuar se Parashtruesi nuk i paraqiti Panelit të Apelit argumente lidhur me interpretimin juridik të nenit 387 të KPS-së, Paneli i Gjykatës Supreme e rrëzoi

Prokurorisë lidhur me Kërkesat për Mbrojtje të Ligjshmërisë, publike, 2 gusht 2023 (“Kundërpërgjigjja e Haradinajt lidhur me Mbrojtjen e Ligjshmërisë”), para. 3-5.

⁹⁸ Kërkesa e Haradinajt për Mbrojtje të Ligjshmërisë, para. 16-17, 19-20; Kundërpërgjigjja e Haradinajt lidhur me Mbrojtjen e Ligjshmërisë, para. 7-8, 10-11.

⁹⁹ Vendimi për Mbrojtje të Ligjshmërisë, para. 40-48.

¹⁰⁰ Vendimi për Mbrojtje të Ligjshmërisë, para. 45.

¹⁰¹ Vendimi për Mbrojtje të Ligjshmërisë, para. 50.

¹⁰² Kërkesa e Haradinajt për Mbrojtje të Ligjshmërisë, para. 2(b), 21-30; Kundërpërgjigjja e Haradinajt lidhur me Mbrojtjen e Ligjshmërisë, para. 12-15.

menjëherë ankesën e tij si të papranueshme.¹⁰³ Për rrjedhojë, Paneli i Gjykatës Supreme trajtoi vetëm argumentet e ngjashme mbi interpretimin juridik të nenit 387 të KPK-së të paraqitura nga z. Gucati në kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë.¹⁰⁴

51. Paneli i Gjykatës Supreme konstatoi se interpretimi i drejtpërdrejtë i nenit 387 të KPK-së tregon se Trupi Gjykses, i konfirmuar nga Paneli i Apelit, e interpretoi saktë këtë dispozitë.¹⁰⁵ Në veçanti, ai theksoi se, në qoftë se panelet do të kishin ndjekur interpretimin e ngushtë të paraqitur nga z. Gucati, kjo do të nënkuptonte se vetëm personat që kanë informacion për pengimin konkret mund të frikësoheshin, dhe jo ata që kanë informacion në lidhje me procedurën penale.¹⁰⁶ Paneli i Gjykatës Supreme gjykoi se interpretimi nga z. Gucati ishte në kundërshtim me synimin dhe qëllimin e nenit 387 të KPK-së dhe me praktikën ekzistuese në gjykatat e Kosovës.¹⁰⁷ Rrjedhimisht, Paneli i Gjykatës Supreme konstatoi se në këtë aspekt nuk ka pasur shkelje të së drejtës penale dhe e rrëzoi ankesën e z. Gucati.¹⁰⁸

3. Shkelja e fshehtësisë së procedurës përmes zbulimit të paautorizuar të identitetit dhe të dhënave personale të dëshmitarëve të mbrojtur

52. Para Panelit të Gjykatës Supreme, Parashtruesi gjithashtu pretendoi se përkufizimi i termit “person i mbrojtur” nga Trupi Gjykses, që u konfirmua nga Paneli i Apelit, ngatërronte nenin 62 të Ligjit - sipas të cilit identitetet dhe të dhënat personale të personave në dokumentacionin e DHS-së apo ZPS-së janë konfidenciale – me statusin e mbrojtur sipas nenit 23 të Ligjit dhe nenit 3(1.3) të Ligjit për Mbrojtjen

¹⁰³ Vendimi për Mbrojtje të Ligjshmërisë, para. 56.

¹⁰⁴ KSC-SC-2023-01, F00002/RED, Version i Redaktuar Publik i Kërkesës së Gucatit për Mbrojtje të Ligjshmërisë sipas nenit 48(6)-(8) të Ligjit dhe Rregullës 193 të Rregullores, publik, 3 maj 2023 (“Kërkesa e Gucatit për Mbrojtje të Ligjshmërisë”), para. 24-37, 44, 47.

¹⁰⁵ Vendimi për Mbrojtje të Ligjshmërisë, para. 60-61.

¹⁰⁶ Vendimi për Mbrojtje të Ligjshmërisë, para. 60.

¹⁰⁷ Vendimi për Mbrojtje të Ligjshmërisë, para. 60.

¹⁰⁸ Vendimi për Mbrojtje të Ligjshmërisë, para. 61, 65.

e Dëshmitarëve, Ligjit nr. 04/L-015, duke shkaktuar, rrjedhimisht, shkelje të së drejtës penale.¹⁰⁹

53. Paneli i Gjykatës Supreme vuri në dukje se Parashtruesi nuk i artikuloi siç duhet argumentet para Panelit të Gjykatës së Apelit, ndonëse ishte e arsyeshme ta kishte bërë këtë.¹¹⁰ Paneli i Gjykatës Supreme gjithashtu mori parasysh se shkelja e pretenduar nuk përbënte ndonjë prej shkeljeve të përmendura në standardin e shqyrtimit¹¹¹ dhe e rrëzoi menjëherë ankesën e Parashtruesit në lidhje me këtë aspekt si të papranueshme.¹¹²

54. Po kështu, duke qenë se argumentet e z. Gucati lidhur me keqinterpretimin e nenit 392(2) të KPK-së kishin të bënin me konstatimet e Trupit Gjykues mbi provat, sikurse u konfirmua nga Paneli i Apelit,¹¹³ dhe, për rrjedhojë, ishin të llojit faktik, Paneli i Gjykatës Supreme i rrëzoi menjëherë ato si të papranueshme.¹¹⁴

4. Argumenti mbrojtës i shtytjes nga ZPS-ja

55. Sa i përket argumentit mbrojtës të shtytjes nga ZPS-ja, Parashtruesi u ankua se Trupi Gjykues dhe Paneli i Apelit shkelën të drejtat e tij sipas nenit 6 të Konventës duke i kërkuar që të paraqiste prova *prima facie* të shtytjes për kryerjen e veprës penale.¹¹⁵ Parashtruesi gjithashtu parashtroi se mungesa e qasjes prej tij në disa prova të disponueshme si për Trupin Gjykues dhe për ZPS-në e rëndoi këtë shkelje dhe se ai më pas u pengua t'ia apelonte këtë Panelit të Gjykatës së Apelit.¹¹⁶ Gjithashtu,

¹⁰⁹ Kërkesa e Haradinajt për Mbrojtje të Ligjshmërisë, para. 2(c), 35-41; Kundërpërgjigjja e Haradinajt lidhur me Mbrojtjen e Ligjshmërisë, para. 17-19.

¹¹⁰ Vendimi për Mbrojtje të Ligjshmërisë, para. 81-82.

¹¹¹ Vendimi për Mbrojtje të Ligjshmërisë, para. 82.

¹¹² Vendimi për Mbrojtje të Ligjshmërisë, para. 83.

¹¹³ Kërkesa e Gucati për Mbrojtje të Ligjshmërisë, para. 81-95.

¹¹⁴ Vendimi për Mbrojtje të Ligjshmërisë, para. 80.

¹¹⁵ Kërkesa e Haradinajt për Mbrojtje të Ligjshmërisë, para. 2(e), 60-66; Kundërpërgjigjja e Haradinajt lidhur me Mbrojtjen e Ligjshmërisë, para. 24-27.

¹¹⁶ Kërkesa e Haradinajt për Mbrojtje të Ligjshmërisë, para. 67-69; Kundërpërgjigjja e Haradinajt lidhur me Mbrojtjen e Ligjshmërisë, para. 28.

Parashtruesi argumentoi se, për rrjedhojë, ishte bërë shkelje e konsiderueshme e të drejtës së tij për gjykim të drejtë sipas nenit 21(2) të Ligjit.¹¹⁷

56. Paneli i Gjykatës Supreme gjykoi se Paneli i Apelit zbatoi saktë jurisprudencën e GJEDNJ-së kur konstatoi se Trupi Gjykses nuk përmbysi detyrimin e vërtetimit në lidhje me pretendimin e Parashtruesit të shtytjes për kryerje të veprave penale nga ZPS-ja.¹¹⁸ Në veçanti, Paneli i Gjykatës Supreme theksoi se në jurisprudencën e GJEDNJ-së thuhet se duhet të ketë disa prova, të cilat në shikim të parë, tregojnë si situata në fjalë mund të cilësohet si shtytje për kryerje të veprës penale dhe se në qoftë se një palë nuk mund të paraqesë prova të tilla, pretendimi i shtytjes për kryerje të veprës penale konsiderohet tërësisht i pagjasë.¹¹⁹ Ai gjithashtu konstatoi se, në mungesë të treguesve për përfshirjen e ZPS-së në tre dorëzimet e dokumenteve konfidenciale në OVL-UÇK, rasti i Parashtruesit nuk ishte rast shtytje për kryerje të veprave penale sipas kuptimit të jurisprudencës së GJEDNJ-së.¹²⁰

57. Së fundi, Paneli i Gjykatës Supreme vuri re se, pavarësisht mungesës së provave *prima facie* për përfshirjen e ZPS-së në kryerjen e veprave penale, Trupi Gjykses gjithsesi bëri përpjekje të mëdha për t'i mundësuar Parashtruesit paraqitjen e argumenteve të veta lidhur me shtytjen për kryerjen e veprave penale.¹²¹ Rrjedhimisht, Paneli i Gjykatës Supreme konstatoi se Parashtruesi nuk arriti të provonte se kishte pasur shkelje thelbësore të procedurave të Rregullores dhe të Ligjit dhe, për rrjedhojë, e rrëzoi ankesën e tij.¹²²

5. Argumenti mbrojtës i interesit publik

58. Parashtruesi parashtroi se iu shkel e drejta për gjykim të drejtë sipas nenit 21(2) të Ligjit, për arsye se Paneli i Apelit nuk konstatoi gabim sa u përket konstatimeve të

¹¹⁷ Kërkesa e Haradinajt për Mbrojtje të Ligjshmërisë, para. 66.

¹¹⁸ Vendimi për Mbrojtje të Ligjshmërisë, para. 91.

¹¹⁹ Vendimi për Mbrojtje të Ligjshmërisë, para. 92.

¹²⁰ Vendimi për Mbrojtje të Ligjshmërisë, para. 94.

¹²¹ Vendimi për Mbrojtje të Ligjshmërisë, para. 95.

¹²² Vendimi për Mbrojtje të Ligjshmërisë, para. 96.

Trupit Gjykses në lidhje me argumentin mbrojtës të interesit publik.¹²³ Në veçanti, Parashtruesi argumentoi se në përkufizimin e ngushtë të interesit publik, Trupi Gjykses nuk mori parasysh elemente shtesë që dëmtonin pavarësinë, paanshmërinë dhe integritetin e hetimeve, si qëndrimin që Serbia ka mbajtur në vite ndaj Kosovës dhe numrin e shumtë të kontakteve ndërmjet TFHS-së/ZPS-së dhe zyrtarëve serbë, disa prej të cilëve shërbyen në regjimin e Millosheviqit.¹²⁴

59. Paneli i Gjykatës Supreme theksoi se Parashtruesi as nuk e evidentoi rregullën procedurale që pretendonte se ishte shkelur në mënyrë thelbësore, as nuk përcaktoi se si shkelja procedurale e pretenduar ndikoi thelbësisht Aktgjykimin e Apelit.¹²⁵ Gjithashtu, Paneli i Gjykatës Supreme konstatoi se argumentet e Parashtruesit ishin të llojit faktik sepse kishin të bënin me mospajtimin e tij me vlerësimet e bëra nga Trupi Gjykses dhe Paneli i Apelit.¹²⁶ Për rrjedhojë, ai e rrëzoi ankesën e Parashtruesit si të papranueshme.¹²⁷

E. ULJA E DËNIMIT

60. Më 12 dhjetor 2023, Kryetarja e DHS-së vendosi ta modifikojë dënimin e Parashtruesit për të mundësuar lirimin e tij me kushtet e përcaktuara në atë vendim, të cilat mbesnin në fuqi për pjesën e mbetur të dënimit të shqiptuar nga Paneli i Apelit, konkretisht deri më 14 dhjetor 2024.¹²⁸ Parashtruesi u lirua më 14 dhjetor 2023.

III. PRETENDIMET PËR SHKELJE

61. Parashtruesi u ankua para Dhomës se ai u shpall fajtor në bazë të interpretimeve pajustificueshmërisht të gjera të neneve 401(1), 387 dhe 392(2) të KPK-së, të cilët ishin

¹²³ Kërkesa e Haradinajt për Mbrojtje të Ligjshmërisë, para. 2(g), 75; Kundërpërgjigjja e Haradinajt lidhur me Mbrojtjen e Ligjshmërisë, para. 35.

¹²⁴ Kërkesa e Haradinajt për Mbrojtje të Ligjshmërisë, para. 75; Kundërpërgjigjja e Haradinajt lidhur me Mbrojtjen e Ligjshmërisë, para. 35.

¹²⁵ Vendimi për Mbrojtje të Ligjshmërisë, para. 124.

¹²⁶ Vendimi për Mbrojtje të Ligjshmërisë, para. 124.

¹²⁷ Vendimi për Mbrojtje të Ligjshmërisë, para. 125.

¹²⁸ KSC-SC-2023-01/CS002, F00005, Vendim mbi Modifikimin e Dënimit, publik, 12 dhjetor 2023, para. 21-22, 25.

të tillë që veprimet e tij nuk përbënin vepra penale sipas këtyre dispozitave në kohën e kryerjes së tyre.¹²⁹ Rrjedhimisht, Parashtruesi pretendoi se interpretimi prej dhomave penale i dispozitave të lartpërmendura shkelte nenin 33(1) të Kushtetutës dhe nenin 7 të Konventës.¹³⁰

62. Gjithashtu, Parashtruesi u ankua se ishte objekt i shtytjes për kryerjen e veprave penale për të cilat u shpall fajtor. Në veçanti, Parashtruesi pretendoi se dhomat penale gabuan në standardin ligjor të zbatuar dhe përmbysën detyrimin e vërtetimit në lidhje me pretendimin e Parashtruesit të shtytjes për kryerje të veprave penale.¹³¹ Ai më tej u ankua se disa prova, të cilat pretendohet se vërtetojnë pretendimin e shtytjes për kryerjen e veprave penale, nuk u nxorën gjatë gjykimit.¹³² Parashtruesi pretendoi shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë sipas nenit 31(2) të Kushtetutës dhe, për rrjedhojë, të nenit 6(1) të Konventës.¹³³

63. Së fundi, Parashtruesi u ankua se pamundësia e dhomave penale për të përjashtuar përgjegjësinë penale të tij në bazë të faktorëve të interesit publik përbënte shkelje të së drejtës së tij për lirinë e shprehjes sipas nenit 40 të Kushtetutës dhe nenit 10 të Konventës.¹³⁴

IV. JURIDIKSIONI

64. Dhoma vëren se Parashtruesi e paraqiti Kërkesën Referuese në bazë të nenit 113(7) të Kushtetutës dhe parashtroi ankesa në lidhje me procesin e zhvilluar kundër tij në DHS. Rrjedhimisht, Kërkesa Referuese ka të bëjë me DHS-në dhe ZPS-në, sikurse përcaktohet në nenin 162(3) të Kushtetutës dhe në nenet 3(1) dhe 49(2) të Ligjit. Për këtë arsye, Dhoma ka juridiksion të marrë vendim mbi Kërkesën Referuese.

¹²⁹ Kërkesa Referuese, para. 2(a), 28, 34-40, 42-43, 47-48, 50.

¹³⁰ Kërkesa Referuese, para. 2(a).

¹³¹ Kërkesa Referuese, para. 54-58, 62.

¹³² Kërkesa Referuese, para. 59-65.

¹³³ Kërkesa Referuese, para. 2(b), 66.

¹³⁴ Kërkesa Referuese, para. 2(c), 67-83.

V. FUSHËVEPRIMI I RISHQYRTIMIT

65. Fillimisht, Dhoma rikujton rolin e vet për mbikëqyrjen e punës së DHS-së dhe ZPS-së në lidhje me të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.¹³⁵ Në bazë të nenit 49(1) të Ligjit, Dhoma është autoriteti përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës në lidhje me juridiksionin lëndor dhe punën e DHS-së dhe ZPS-së.

66. Sa u përket të drejtave dhe lirive themelore të garantuara në Kapitullin II të Kushtetutës, Dhoma thekson se, në bazë të nenit 22(2) të Kushtetutës, garancitë e parashikuara në Konventë gjejnë zbatim në nivel kushtetues.¹³⁶ Faktikisht, Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka ritheksuar se të drejtat dhe liritë e garantuara nga instrumentet ndërkombëtare të përmendura në nenin 22 të Kushtetutës “kanë statusin e normave të rendit kushtetues dhe janë pjesë integrale e Kushtetutës, në të njëjtën mënyrë si të gjitha dispozitat e tjera të Kushtetutës”.¹³⁷ Në këtë aspekt, Dhoma rikujton se ankesat e Parashtruesit kanë lidhje me nenet 33(1), 31(2) dhe 40 të Kushtetutës dhe nenet 7, 6(1) dhe 10 të Konventës. Rrjedhimisht, Dhoma konstaton se Kërkesa Referuese shqyrtohet në bazë të neneve 33(1), 31(2) dhe 40 të Kushtetutës dhe neneve 7, 6(1) dhe 10 të Konventës.¹³⁸

67. Në lidhje me vlerësimin e Kërkesës Referuese, Dhoma vë në dukje se, në përputhje me nenin 53 të Kushtetutës, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë “interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të [GJEDN]-së”. Gjithashtu, Gjykata Kushtetuese e Kosovës vazhdimisht e ka njohur

¹³⁵ Shih, gjithashtu KSC-CC-2019-05, F00012, Vendim mbi Referimin e Mahir Hasanit në lidhje me Urdhrin e Prokurorisë të 20 dhjetorit 2018, publik, 20 shkurt 2019 (“Vendimi mbi Referimin e z. Hasani në lidhje me Urdhrin e ZPS-së”), para. 24.

¹³⁶ Shih, për shembull KSC-CC-2022-13, F00010; KSC-CC-2022-14, F00009, Vendim mbi Kërkesën Referuese të Jakup Krasniqit në lidhje me Ligjshmërinë e Akuzës së Ndërmarrjes Kriminale të Përbashkët dhe Kërkesën Referuese të Kadri Veselit në lidhje me Vendimin e Panelit të Apelit për Kundërshtimet ndaj Juridiksionit të Dhomave të Specializuara, publik, 13 qershor 2022 (“Vendimi mbi Kërkesat Referuese të J. Krasniqit dhe K. Veselit në lidhje me Akuzat Penale”), para. 34, me referenca të mëtejshme në jurisprudencë.

¹³⁷ Kosovë, Gjykata Kushtetuese, Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimeve [A.A.U.ZH. nr. 20/2019 të 30 tetorit 2019; dhe A.A.U.ZH. nr. 21/2019, të 5 nëntorit 2019] të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, KI 207/19, Aktgjykim, 10 dhjetor 2020 (5 janar 2021), para. 111.

¹³⁸ Vendimi mbi Kërkesat Referuese të J. Krasniqit dhe K. Veselit në lidhje me Akuzat Penale, para. 35.

zbatimin e nenit 53 të Kushtetutës në vlerësimet e referimeve kushtetuese.¹³⁹ Ajo gjithashtu është shprehur se “Gjykata Kushtetuese është e obliguar që të interpretojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore në pajtim me vendimet gjyqësore të [GJEDNJ-së]”.¹⁴⁰ Mbi këtë bazë, dhe duke pasur parasysh nenet 22(2) dhe 53 të Kushtetutës, kjo Dhomë në veçanti ka mbajtur parasysh jurisprudencën e GJEDNJ-së në shqyrtimin e Kërkesës Referuese të Parashtruesit.¹⁴¹

68. Së fundi, Dhoma rikujton se detyra e saj, sipas nenit 113(7) të Kushtetutës dhe nenit 49(1) dhe (3) të Ligjit, është të vlerësojë nëse parregullsitë për të cilat ankohet Parashtruesi kanë shkelur të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë.¹⁴² Rrjedhimisht, Dhoma nuk vendos për fajësinë apo pafajësinë e Parashtruesit.¹⁴³ Po ashtu, Dhoma nuk ka për detyrë të përcaktojë nëse konstatimet e dhomave penale ishin të sakta në aspektin faktik apo ligjor.¹⁴⁴ Përndryshe, Dhoma do të vepronte si një dhomë apeli, që do të nënkuptonte mosrespektimin e kufizimeve të

¹³⁹ Shih, për shembull Kosovë, Gjykata Kushtetuese, *Kërkesë për Vlerësim të Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Pml nr. 225/2017 të 18 dhjetorit 2017*, KI 37/18, *Aktvendim për papranueshmëri*, 30 maj 2018 (11 qershor 2018), para. 37; *Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Vendimit Pn II nr. 1/17 të Gjykatës Supreme të Kosovës të 30 Janarit 2017 në lidhje me Vendimin Pml nr. 300/16 të Gjykatës Supreme të 12 dhjetorit 2016*, KI 62/17, *Aktgjykim*, 29 maj 2018 (11 qershor 2018), para. 43; *Kërkesë për vlerësim të Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Pml nr. 225/2017 të 18 dhjetorit 2017*, KI 34/18, *Aktvendim për papranueshmëri*, 23 maj 2018 (11 qershor 2018), para. 41.

¹⁴⁰ Shih Kosovë, Gjykata Kushtetuese, *Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës PML. nr. 181/15, të 6 nëntorit 2015*, KI 43/16, *Aktvendim për Papranueshmëri*, 14 prill 2016 (16 maj 2016), para. 50 (theksimi i shtuar).

¹⁴¹ Shih, gjithashtu, *Vendimin mbi Referimin e z. Hasani në lidhje me Urdhrin e ZPS-së*, para. 26.

¹⁴² KSC-CC-2022-15, F00010, *Vendim mbi Kërkesën Referuese të Hashim Thaçit në lidhje me të Drejtën për një Gjykatë të Pavarur dhe të Paanshme të Themeluar me Ligj dhe për Mendim të Arsytuar, publik*, 13 qershor 2022 (*“Vendim mbi Kërkesën Referuese të H. Thaçit lidhur me Kundërshtimin e Juridiksionit”*), para. 41; Kosovë, Gjykata Kushtetuese, *Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Pml nr. 19/2022 të 15 shkurtit 2022*, KI 74/22, *Aktgjykim*, 7 nëntor 2023 (5 dhjetor 2023), para. 72.

¹⁴³ *Vendim mbi Kërkesën Referuese të H. Thaçit lidhur me Kundërshtimin e Juridiksionit*, para. 41; Kosovë, Gjykata Kushtetuese, *Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Pml nr. 224/220 të 17 shtatorit 2020*, KI 31/21, *Aktvendim për papranueshmëri*, 5 maj 2021 (21 maj 2021), para. 35.

¹⁴⁴ KSC-CC-2020-08, F00020/RED, Version i redaktuar publik i *Vendimit mbi Kërkesën Referuese të [REDAKTUAR] në vijim të vendimit të Gjykatës të Vetëm, publik*, 20 prill 2020 (*“Vendimi në lidhje me Vendimin e Gjykatës të Vetëm”*), para. 36. Shih gjithashtu Kosovë, Gjykata Kushtetuese, KI 31/21, përmendur më lart, para. 35-36.

juridiksionit të vet sipas neneve 113 dhe 162(3) të Kushtetutës.¹⁴⁵

69. Dhoma mund t'i vërë në dyshim këto konstatime vetëm nëse ato janë arbitrare në mënyrë aq flagrante dhe qartazi, saqë në vetvete shkaktjnë shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë.¹⁴⁶ Për shembull, ndër të tjera, kjo mund të ndodhë në rastin e gabimeve të dukshme në vlerësim, të cilat nuk do t'i kishte bërë asnjë gjykatë e arsyeshme,¹⁴⁷ përfundimeve të paarsyeshme lidhur me fakte që janë kaq të dukshme dhe të qarta në pamje të parë, saqë bëjnë që konstatimet e një gjykate të duken krejtësisht arbitrare,¹⁴⁸ ose si interpretim dhe zbatim i gabuar në mënyrë të dukshme të ligjit relevant, ose arsyetim që nuk ka bazë ligjore ose është aq i pasaktë saqë mund të interpretohet si tejet arbitrar ose si mohim i drejtësisë.¹⁴⁹

VI. PRANUESHMËRIA

70. Së pari, Dhoma duhet të përcaktojë nëse janë të pranueshme ankesat e shumta të paraqitura nga Parashtruesi.¹⁵⁰ Kjo rrjedh nga neni 113(1) i Kushtetutës, sipas të cilit Dhoma vendos vetëm për raste “të ngritura para [saj] në mënyrë të ligjshme nga palë të autorizuar”.¹⁵¹ Gjithashtu, rregulla 15(1) e KPK-së përcakton se Dhoma vendos mbi

¹⁴⁵ *Vendimi në lidhje me Vendimin e Gjykatës të Vetëm*, para. 36; Kosovë, Gjykata Kushtetuese, *Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Pml nr. 41/2017 të 3 korrikut 2017*, KI 119/17, Aktvendim për papranueshmëri, 3 prill 2019 (3 maj 2019), para. 87. Shih gjithashtu ECtHR, *Kemmache v. France* (no. 3), no. 17621/91, 24 November 1994, para. 44.

¹⁴⁶ *Vendimi në lidhje me Vendimin e Gjykatës të Vetëm*, para. 36; ECtHR, *De Tommaso v. Italy* [GC], no. 43395/09, 23 February 2017, para. 170; Kosovë, Gjykata Kushtetuese, KI 37/18, përmendur më lart, para. 41.

¹⁴⁷ ECtHR, *Dulaurans v. France*, no. 34553/97, 21 March 2000, paras 33-39. Shih gjithashtu ECtHR, *Bochan v. Ukraine* (no. 2) [GC], no. 22251/08, 5 February 2015, para. 62.

¹⁴⁸ ECtHR, *Khamidov v. Russia*, no. 72118/08, 15 November 2007, paras 170-175.

¹⁴⁹ ECtHR, *Andelković v. Serbia*, no. 1401/08, 9 April 2013, paras 24-29; *Bochan v. Ukraine* (no. 2) [GC], përmendur më lart, paras 60-65.

¹⁵⁰ KSC-CC-2023-21, F00006, Vendim mbi Kërkesën Referuese të Pjetër Shalës drejtuar Panelit të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me Shkeljen e të Drejtave Themelore të z. Shala të Garantuara nga Nenet 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës së Kosovës dhe Nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, publik, 29 gusht 2023 (“*Vendimi mbi Kërkesën Referuese të P. Shalës në lidhje me Pranueshmërinë e Deklaratave të Mëparshme*”), para. 19. Shih gjithashtu *Vendimin mbi Kërkesat Referuese të J. Krasniqit dhe K. Veselit në lidhje me Akuzat Penale*, para. 36.

¹⁵¹ Shih *Vendimin mbi Kërkesën Referuese të P. Shalës në lidhje me Pranueshmërinë e Deklaratave të Mëparshme*, para. 19; KSC-CC-2022-19, F00004/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesën Referuese

“pranueshmërinë dhe/ose themelësinë e një referimi të bërë në bazë të nenit 49 të Ligjit”. Këto dispozita parashikojnë përgjegjësinë e Dhomës për të vlerësuar së pari *ex officio* nëse Kërkesa Referuese është e pranueshme apo jo.¹⁵²

71. Për këtë arsye, Dhoma do të shqyrtojë aspektet e pranueshmërisë duke pasur parasysh disa prej kritereve të pranueshmërinë të përcaktuara në Kushtetutë, në Ligj dhe në Rregulloren e DHSGJK-së, të cilat ekzistojnë në procesin aktual. Duke pasur parasysh se Parashtruesi paraqiti disa ankesa në Kërkesën Referuese, pranueshmëria shqyrtohet për secilën ankesë.

A. PRETENDIMI PËR SHKELJE TË NENIT 33(1) TË KUSHTETUTËS DHE NENIT 7 TË KONVENTËS

1. Parashtrimet

72. Fillimisht, Parashtruesi argumentoi se, duke paraqitur kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, e cila u rrëzua më 18 shtator 2023 nga Paneli i Gjykatës Supreme, ishte përmbushur kriteri i përcaktuar në nenin 113(7) të Kushtetutës për shterimin e të gjitha mjeteve juridike efektive të përcaktuara në ligj.¹⁵³ Parashtruesi më tej parashtroi se, duke qenë se kërkesat referuese drejtuar Dhomës trajtojnë aspekte me rëndësi të veçantë juridike, mosparaqitja e këtyre argumenteve para dhomave penale në një fazë

të Pjetër Shalës në lidhje me të Drejtat Themelore të Garantuara nga Nenet 31 dhe 32 të Kushtetutës së Kosovës dhe Nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, publik, 15 dhjetor 2022 (“Vendimi mbi Kërkesën Referuese të P. Shalës lidhur me Kërkesën për Heqjen e Prokurorit të Specializuar”), para. 14. Shih gjithashtu Kosovë, Gjykata Kushtetuese, *Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit AE. nr. 287/18 të 27 majit 2019 dhe Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike Vendimit I.EK. nr. 330/2019 të 1 gushtit 2019, KI 195/19, Aktgjykim, 5 maj 2021 (31 maj 2021), para. 68-69; Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme, Pml. nr. 313/2018, të 10 dhjetorit 2018, KI 12/19, Aktvendim për papranueshmëri, 10 prill 2019 (3 maj 2019), para. 30-31.*

¹⁵² *Vendimi mbi Kërkesën Referuese të P. Shalës në lidhje me Pranueshmërinë e Deklaratave të Mëparshme, para. 19; Vendimi mbi Kërkesën Referuese të P. Shalës lidhur me Kërkesën për Heqjen e Prokurorit të Specializuar, para. 14; Vendim mbi Kërkesën Referuese të H. Thaçit lidhur me Kundërshtimin e Juridiksionit, para. 43.*

¹⁵³ Kërkesa Referuese, para. 22.

të mëhershme, nuk duhet të pengojë shqyrtimin e duhur në lidhje me themelësinë e tyre.¹⁵⁴

73. Sa i përket pretendimit për shkelje të nenit 33(1) të Kushtetutës dhe nenit 7 të Konventës,¹⁵⁵ Parashtruesi argumentoi se interpretimi prej dhomave penale i neneve 401(1), 387 dhe 392(2) të KPK-së zgjeroi ndjeshëm kuptimin e këtyre dispozitave duke konstatuar se: (i) përdorimi i forcës ose i kërcënimit të rëndë kundër palëve të treta është i mjaftueshëm për të përmbushur veprimin e fajshëm dhe synimin për vepër penale sipas nenit 401(1) të KPK-së;¹⁵⁶ (ii) fraza “kur informacione të tilla ndërlidhen me pengimin e procedurës penale” cilëson vetëm alternativën e tretë nga tre alternativa lidhur me veprimet dhe mosveprimet sipas nenit 387 të KPK-së, në vend që t’i cilësojë të gjitha;¹⁵⁷ dhe (iii) një “person i mbrojtur në procedurën penale” sipas kuptimit të nenit 392(2) të KPK-së mund të jetë çdo person që është objekt i masave mbrojtëse të miratuara nga ZPS-ja, si dhe një person identiteti ose të dhënat personale të të cilit gjenden në dokumentet ose materialet e DHS-së ose ZPS-së nxjerrja e të cilave nuk është e autorizuar.¹⁵⁸

74. Në lidhje me këtë aspekt, Parashtruesi gjithashtu argumentoi se, bazuar në arsyet e paraqitura në fillim, Dhoma nuk duhet të rrëzojë pretendimet e tij në lidhje me nenet 387 dhe 392(2) të KPK-së me arsyetimin se ato nuk i ishin paraqitur Panelit të Apelit, sikurse arsyetoi Paneli i Gjykatës Supreme.¹⁵⁹

75. ZPS-ja parashtroi se, për të shteruar të gjitha mjetet juridike, parashtruesit e kërkesave duhet të shfrytëzojnë të gjitha mjetet procedurale efektive në dispozicion të tyre, përpara se t’i paraqesin kërkesë referuese Dhomës.¹⁶⁰ ZSP-ja argumentoi se shpresa e parashtruesit të kërkesës për të përfituar nga argumentet e të tjerëve nuk e

¹⁵⁴ Kërkesa Referuese, para. 26.

¹⁵⁵ Kërkesa Referuese, para. 2(a).

¹⁵⁶ Kërkesa Referuese, para. 34-40, 50.

¹⁵⁷ Kërkesa Referuese, para. 42-43, 50.

¹⁵⁸ Kërkesa Referuese, para. 47-48, 50.

¹⁵⁹ Kërkesa Referuese, para. 44, 49.

¹⁶⁰ Parashtrimet e ZPS-së, para. 14.

përrjashton detyrimin e tij për të përdorur mjetet juridike, ose bashkërisht, ose më vete.¹⁶¹ ZPS-ja parashtroi se mosparaqitja e argumenteve që mund t'i ishin paraqitur më herët dhomave penale, do të thotë se nuk janë shteruar të gjitha mjetet juridike dhe përbën arsye për ta shpallur kërkesën referuese, ose pjesë të saj, të papranueshme.¹⁶² ZPS-ja më tej parashtroi se pretendimet e Parashtruesit në lidhje me nenin 401(1) të KPK-së ishin të papranueshme, sepse ai thjesht shprehu pakënaqësinë me interpretimin juridik të bërë nga dhomat penale.¹⁶³

76. Sipas ZPS-së, edhe argumentet e Parashtruesit lidhur me nenin 387 të KPK-së duhet të rrëzohen si të papranueshme për shkak se nuk janë shteruar të gjitha mjetet juridike.¹⁶⁴ ZPS-ja gjithashtu parashtroi se pretendimeve të Parashtruesit në lidhje me nenin 392(2) të KPK-së u kishte kaluar afati sepse ato iu paraqitën në mënyrë qartësisht joefektive Panelit të Gjykatës Supreme.¹⁶⁵ Së fundi, ZPS-ja argumentoi se interpretimet juridike në fjalë përputheshin tërësisht me Kushtetutën dhe Konventën.¹⁶⁶

77. Në Kundërpërgjigje, Parashtruesi parashtroi se kriteret për shterimin e mjeteve juridike nuk janë as absolute, as nuk mund të zbatohen automatikisht.¹⁶⁷ Në veçanti, ai argumentoi se, sipas çështjes gjyqësore *Vladimir Romanov k. Rusisë (Vladimir Romanov v. Russia)*,¹⁶⁸ gabimet në procedurën zyrtare nuk përbëjnë mosshkrim të mjeteve juridike, kur gjykatat vendore gjithsesi e shqyrtuan thelbin e ankesës së parashtruesit.¹⁶⁹ Më konkretisht, sa i përket pranueshmërisë së argumenteve të tij lidhur me interpretimin e nenit 401(1) të KPK-së, Parashtruesi u mbështet në çështjen

¹⁶¹ Parashtrimet e ZPS-së, para. 14.

¹⁶² Parashtrimet e ZPS-së, para. 14.

¹⁶³ Parashtrimet e ZPS-së, para. 15, 19.

¹⁶⁴ Parashtrimet e ZPS-së, para. 22.

¹⁶⁵ Parashtrimet e ZPS-së, para. 13, 26.

¹⁶⁶ Parashtrimet e ZPS-së, para. 18-21, 24-25, 27-29.

¹⁶⁷ Parashtrimet e Parashtruesit të Kërkesës, para. 12.

¹⁶⁸ Shih Parashtrimet e Parashtruesit të Kërkesës, para. 12, i referohet ECtHR, *Vladimir Romanov v. Russia*, no. 41461/02, 24 July 2008, para. 52.

¹⁶⁹ Parashtrimet e Parashtruesit të Kërkesës, para. 12.

gjyqësore të GJEDNJ-së *Vasiliauskas k. Lituanisë (Vasiliauskas v. Lithuania [GC])*,¹⁷⁰ duke argumentuar se kompetencat e Dhomës për shqyrtim janë më të mëdha kur vetë e drejta e Konventës, konkretisht neni 7 në rastin e tij, kërkon bazë ligjore për vendimin e fajësisë dhe dënimin.¹⁷¹

78. Në lidhje me argumentet e tij lidhur me interpretimin e nenit 387 të KPK-së, Parashtruesi bëri të ditur se Paneli i Gjykatës Supreme e shqyrtoi thelbin e tyre në kontekstin e argumenteve të ngjashme të ngritura nga z. Gucati dhe, për rrjedhojë, parashtroi se ai nuk duhet të pengohet që t'ia paraqesë ato Dhomës.¹⁷² Parashtruesi gjithashtu pretendoi se, duke qenë se Paneli i Apelit kishte shqyrtuar përmbajtjen ligjore të nenit 392(2) të KPK-së në lidhje me z. Gucati, Paneli i Gjykatës Supreme gaboi që rrëzoi argumentin e tij si të papranueshëm.¹⁷³ Rrjedhimisht, Parashtruesi argumentoi se ai nuk duhet të përjashtohet që t'ia paraqesë të njëjtin pretendim kësaj Dhome.¹⁷⁴

2. Vlerësimi i Dhomës

79. Fillimisht, Dhoma vëren se Parashtruesi paraqiti tre pretendime të ndryshme në lidhje me ankesën e tij sipas nenit 33(1) të Kushtetutës dhe nenit 7 të Konventës. Në veçanti, Parashtruesi u ankua se, me interpretimet përkatësisht të neneve 401(1), 387 dhe 392(2) të KPK-së, dhomat penale e zgjeruan ndjeshëm kuptimin e këtyre dispozitave. Sidoqoftë, duke pasur parasysh se Parashtruesi nuk ua paraqiti disa nga këto argumente dhomave penale në faza të ndryshme të procesit penal kundër tij, shtrohet pyetja nëse Parashtruesi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me ligj për pretendimet e tij lidhur me interpretimin e neneve 387 dhe 392(2) të KPK-së nga dhomat penale. Në këtë aspekt, Dhoma vëren se, në bazë të nenit 113(7) të Kushtetutës, nenit 49(3) të Ligjit, dhe rregullës 20(1)(a) të Rregullores

¹⁷⁰ Parashtrimet e Parashtruesit të Kërkesës, para. 16, i referohet ECtHR, *Vasiliauskas v. Lithuania [GC]*, no. 35343/05, 20 October 2015, para. 161.

¹⁷¹ Parashtrimet e Parashtruesit të Kërkesës, para. 16-17.

¹⁷² Parashtrimet e Parashtruesit të Kërkesës, para. 20.

¹⁷³ Parashtrimet e Parashtruesit të Kërkesës, para. 27.

¹⁷⁴ Parashtrimet e Parashtruesit të Kërkesës, para. 27.

së DHSGJK-së, një individ mund t'i paraqesë kërkesë referuese Dhomës pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me ligj kundër shkeljes së pretenduar.

80. Fillimisht, Dhoma rikujton se rregulla për shterimin e mjeteve juridike ka për qëllim t'u japë autoriteteve përkatëse mundësinë për të parandaluar ose korrigjuar shkeljet e pretenduara të Kushtetutës dhe/ose të Konventës.¹⁷⁵ Kjo bazohet në supozimin, e pasqyruar në nenin 32 të Kushtetutës dhe nenin 13 të Konventës, se rendi juridik relevant ofron mjet juridik efektiv ndaj shkeljes së të drejtave kushtetuese.¹⁷⁶ Në kornizën ligjore të DHS-së, në parim, kjo garantohet përmes dhomave penale. Kriteri sipas të cilit duhet të shterohen të gjitha mjetet juridike është aspekt i rëndësishëm i natyrës dytësore të mekanizmit për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese dhe pjesë e domosdoshme e funksionimit të tij.¹⁷⁷ Rrjedhimisht, ata që duan të kërkojnë zbatimin e juridiksionit mbikëqyrës të Dhomës duhet që së pari të shfrytëzojnë mjetet juridike të zakonshme që janë të disponueshme dhe efektive në lidhje me ankesat e tyre kushtetuese.¹⁷⁸

¹⁷⁵ Shih, për shembull Kosovë, Gjykata Kushtetuese, *Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Vendimit [KPK/nr. 475/2022] për propozimin e z. Blerim Isufaj për pozitën e Kryeprokurorit të Shtetit të 6 prillit 2022 të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Vendimit [KPK/nr.474/2022] për Refuzimin e Raportit të 6 prillit 2022 të Komisionit për Rishqyrtim të Këshillit Prokurorial të Kosovës*, KI 57/22 dhe KI 79/22, Aktvendim për papranueshmëri, 4 korrik 2022 (25 korrik 2022), para. 70; *Kërkesë për vlerësim të Kushtetutshmërisë së Vendimit nr. 64/04 të Agjencisë së Regjistrimit Civil të 13 qershorit 2018*, KI 108/18, Aktvendim për papranueshmëri, 5 shtator 2019 (30 shtator 2019), para. 153; *Vlerësim i Kushtetutshmërisë së aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, PA-II-KZ-II-7/15, të 26 nëntorit 2015*, KI 15/16, Aktvendim për papranueshmëri, 16 mars 2016 (5 prill 2016), para. 41. Gjithashtu, shih ECtHR, *Gherghina v. Romania* (dec.) [GC], no. 42219/07, 9 July 2015, para. 83-84, me referenca të mëtejshme në jurisprudencë.

¹⁷⁶ Kosovë, Gjykata Kushtetuese, KI 57/22 dhe KI 79/22, përmendur më lart, para. 70; KI 108/18, përmendur më lart, para. 153; KI 15/16, përmendur më lart, para. 41. Shih gjithashtu ECtHR, *Gherghina v. Romania* (dec.) [GC], përmendur më lart, para. 83.

¹⁷⁷ Kosovë, Gjykata Kushtetuese, KI 57/22 dhe KI 79/22, përmendur më lart, para. 71; KI 108/18, përmendur më lart, para. 153; KI 15/16, përmendur më lart, para. 42. Shih gjithashtu ECtHR, *Gherghina v. Romania* (dec.) [GC], përmendur më lart, para. 83; *Demopoulos and Others v. Turkey* (dec.) [GC], no. 46113/99, 1 March 2010, para. 69.

¹⁷⁸ Kosovë, Gjykata Kushtetuese, KI 108/18, përmendur më lart, para. 154. Shih gjithashtu ECtHR, *Gherghina v. Romania* (dec.) [GC], përmendur më lart, para. 85; *Akdivar and Others v. Turkey* [GC], no. 21893/93, 16 September 1996, para. 66.

81. Më konkretisht, Dhoma thekson se, në kornizën ligjore të DHS-së, sipas nenit 47 të Ligjit, në disa raste të përcaktuara konkretisht, Paneli i Gjykatës Supreme shqyrton ankesa kundër një aktgjykimi të Panelit të Gjykatës së Apelit. Në përputhje me nenin 48(6)-(7) të Ligjit, pas daljes së aktgjykimit të formës së prerë, Panelit të Gjykatës Supreme mund t'i paraqitet kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në lidhje me shkelje të së drejtës penale të përfshirë në Ligj, ose shkelje të konsiderueshme të procedurave të përcaktuara në Ligj dhe Rregullore.¹⁷⁹ Rrjedhimisht, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është një nga mjetet juridike që, në parim, duhej të shfrytëzohej për të përcaktuar nëse janë shteruar të gjitha mjetet juridike në lidhje me shkeljet e pretenduara, të cilat kanë të bëjnë me procedurën penale kundër Parashtruesit që u zhvillua në DHS.¹⁸⁰

82. Dhoma rikujton se kriteret nëse është përmbushur detyrimi për shterimin e të gjitha mjeteve juridike të efektshme të përcaktuara me ligj është pranuar gjerësisht në jurisprudencën e GJEDNJ-së, në përputhje me të cilën, bazuar në nenin 53 të Kushtetutës, Dhoma është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.¹⁸¹ Të njëjtat parime janë zhvilluar edhe në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës.¹⁸² Për rrjedhojë, Dhoma i referohet jurisprudencës

¹⁷⁹ Shih, gjithashtu, *Vendimin mbi Kërkesat Referuese të J. Krasniqit dhe K. Veselit në lidhje me Akuzat Penale*, para. 56; *Vendimin mbi Kërkesën Referuese të H. Thaçit lidhur me Kundërshtimin e Juridiksionit*, para. 66.

¹⁸⁰ Shih *Vendimin mbi Kërkesat Referuese të J. Krasniqit dhe K. Veselit në lidhje me Akuzat Penale*, para. 56; *Vendimin mbi Kërkesën Referuese të H. Thaçit lidhur me Kundërshtimin e Juridiksionit*, para. 67. Shih gjithashtu, ndër të tjera, Kosovë, Gjykata Kushtetuese, *Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës*, Pml. Nr. 242/2017, i 30 prillit 2018, KI 01/19, Aktvendim për papranueshmëri, 2 shtator 2020 (1 tetor 2020), para. 2, 31-41, 91-93; *Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës*, Pml. Nr. 242/2017 i 6 shkurtit 2018, KI 95/18, Aktvendim për papranueshmëri, 27 maj 2019 (19 gusht 2019), para. 3, 12-17, 22; *Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës*, Pml 125/14, i datës 8 korrik 2014, KI 185/14, Aktvendim për papranueshmëri, 8 korrik 2015 (28 shtator 2015), para. 2, 12-13, 21, 29.

¹⁸¹ Shih më lart, para. 67. Shih, gjithashtu, Kosovë, Gjykata Kushtetuese, KI 57/22 dhe KI 79/22, përmendur më lart, para. 69.

¹⁸² Shih, ndër të tjera, Kosovë, Gjykata Kushtetuese, *Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës* Pml nr. 63/2018 i 4 qershorit 2018, KI 155/18, Aktvendim për papranueshmëri, 25 shtator 2019 (21 tetor 2019), para. 34-38; KI 119/17, përmendur më lart, para. 71-73.

së GJEDNJ-së dhe Gjykatës Kushtetuese të Kosovës në lidhje me kriterin për shterimin e mjeteve juridike.¹⁸³

83. Lidhur me këtë aspekt, Dhoma gjithashtu thekson se thjesht fakti se parashtruesi i kërkesës i ka paraqitur argumentet e veta gjykatës përkatëse, nuk përbën në vetvete zbatim të nenit 113(7) të Kushtetutës, nenit 49(3) të Ligjit dhe rregullës 20(1)(a) të Rregullores së DHSGJK-së.¹⁸⁴ Domethënë, për t'i shteruar siç duhet mjetet juridike, parashtruesi i kërkesës aktualisht duhet të jetë ankuar, shprehimisht ose në thelb, për shkelje të Kushtetutës ose të Konventës, në një mënyrë që nuk lë dyshim se e njëjta ankesë që iu paraqit Dhomës, faktikisht i ishte paraqitur autoriteteve relevante, konkretisht, në këtë kontekst, dhomave penale.¹⁸⁵

84. Ndonëse rregulla për shterimin e mjeteve juridike duhet të zbatohet me njëfarë fleksibiliteti dhe pa formalizëm të tepruar, zakonisht ajo kërkon që ankesat që i paraqiten Dhomës duhet t'i ishin paraqitur gjykatave relevante, të paktën në thelb dhe në përputhje me kriteret formale dhe afatet e përcaktuara në Ligj dhe në Rregullore.¹⁸⁶ Sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së, kjo do të thotë se parashtruesi i kërkesës duhet të paraqesë argumente juridike me të njëjtin efekt ose efekt të ngjashëm bazuar në dispozitat ligjore të zbatueshme, në mënyrë që t'u japë dhomave penale mundësinë për të korrigjuar shkeljen e pretenduar.¹⁸⁷ Dhoma vë në dukje se kjo kërkon që të merren parasysh jo vetëm faktet, por edhe argumentet ligjore të parashtruesit të kërkesës.¹⁸⁸

¹⁸³ Kosovë, Gjykata Kushtetuese, KI 119/17, përmendur më lart, para. 70.

¹⁸⁴ Shih, për shembull ECtHR, *Novak v. Croatia* (dec.), no. 20737/15, 16 March 2021, para. 23.

¹⁸⁵ ECtHR, *Farzaliyev v. Azerbaijan*, no. 29620/07, 28 May 2020, para. 55; *Nicklinson and Lamb v. the United Kingdom* (dec.), nos 2478/15 and 1787/15, 23 June 2015, para. 90; *Merot d.o.o and Storitve Tir d.o.o v. Croatia* (dec.), nos 29426/08 and 29737/08, 10 December 2013, para. 36. Shih gjithashtu Kosovë, Gjykata Kushtetuese, KI 119/17, përmendur më lart, para. 72-73.

¹⁸⁶ Shih, për shembull ECtHR, *Nicklinson and Lamb v. the United Kingdom* (dec.), përmendur më lart, para. 90; *Kaya v. Germany* (dec.), no. 31753/02, 11 May 2006, f. 8. Shih gjithashtu Kosovë, Gjykata Kushtetuese, KI 119/17, përmendur më lart, para. 71.

¹⁸⁷ ECtHR, *Novak v. Croatia* (dec.), përmendur më lart, para. 24.

¹⁸⁸ ECtHR, *Radomilja and Others v. Croatia* [GC], nos 37685/10 and 22768/12, 20 March 2018, para. 117; *Novak v. Croatia* (dec.), përmendur më lart, para. 24.

85. Në lidhje me këtë, Dhoma gjithashtu vë në dukje se, në përputhje me jurisprudencën e GJEDNJ-së, rregulla për shterimin e mjeteve juridike nuk mund të përdoret kundër parashtruesit të kërkesës në qoftë se, pavarësisht mosrespektimit prej këtij të fundit të formave të përcaktuara në ligj, autoriteti relevant gjithsesi ka shqyrtuar thelbin e ankesës së tij apo të saj.¹⁸⁹ Gjithashtu, Dhoma vëren se, gjatë shqyrtimit nëse rregulla për shterimin e mjeteve juridike është respektuar, është thelbësore të merren parasysh rrethanat e rastit individual.¹⁹⁰ Më konkretisht, Dhoma duhet të marrë realisht parasysh jo vetëm mjetet juridike formale ekzistuese në kornizën ligjore relevante, por edhe kontekstin e përgjithshëm në të cilin veprojnë, si dhe rrethanat personale të parashtruesit të kërkesës.¹⁹¹

86. Rrjedhimisht, Dhoma duhet të përcaktojë, në rrethanat e çështjes, nëse parashtruesi i kërkesës bëri gjithçka që mund të pritej në mënyrë të arsyeshme prej tij për shterimin e mjeteve juridike.¹⁹² Dhoma vë në dukje se parashtruesi i kërkesës mund të përjashtohet nga ky kusht vetëm në qoftë se tregon se mjete juridik ishte për ndonjë arsye i pamjaftueshëm dhe joefektiv në rrethanat konkrete të çështjes, ose në qoftë se ekzistonin rrethana të veçanta që e çlironin atë prej këtij detyrimi.¹⁹³

87. Sa i përket pretendimit të Parashtruesit në lidhje me interpretimin e nenit 387 të KPK-së nga dhomat penale, Dhoma vëren se, ndonëse Parashtruesi, i ndihmuar nga avokati i tij, bëri të ditur në njoftimin për apel synimin e tij për të kundërshtuar

¹⁸⁹ Shih, ndër të tjera, ECtHR, *Savickis and Others v. Latvia* [GC], no. 49270/11, 9 Juny 2022, para. 140; *Ulemek v. Croatia*, no. 21613/16, 31 October 2019, para. 77; *Vladimir Romanov v. Russia*, përmendur më lart, para. 52; *Kaya v. Germany* (dec.), përmendur më lart, f. 8.

¹⁹⁰ ECtHR, *Vladimir Romanov v. Russia*, përmendur më lart, para. 50; *D.H. and Others v. the Czech Republic* [GC], no. 57325/00, 13 November 2007, para. 116; *Akdivar and Others v. Turkey* [GC], përmendur më lart, para. 69.

¹⁹¹ ECtHR, *D.H. and Others v. the Czech Republic* [GC], përmendur më lart, para. 116; *Akdivar and Others v. Turkey* [GC], përmendur më lart, para. 69. Shih gjithashtu Kosovë, Gjykata Kushtetuese, KI 108/18, para. 155.

¹⁹² ECtHR, *D.H. and Others v. the Czech Republic* [GC], përmendur më lart, para. 116; *Akdivar and Others v. Turkey* [GC], përmendur më lart, para. 69. Shih gjithashtu Kosovë, Gjykata Kushtetuese, KI 108/18, para. 159.

¹⁹³ Shih, ndër të tjera, ECtHR, *Gherghina v. Romania* (dec.) [GC], përmendur më lart, para. 89; *Vučković and Others v. Serbia* [GC], no. 17153/11, 25 March 2014, para. 77. Shih gjithashtu Kosovë, Gjykata Kushtetuese, KI 108/18, para. 158, 160.

interpretimin e Trupit Gjykes se çfarë përfshin fraza “kur informacione të tilla ndërlidhen me pengimin e procedurës penale” në nenin 387 të KPK-së, në Dosjen e Apelit ai hoqi dorë prej kësaj pike.¹⁹⁴ Dhoma gjithashtu mban parasysh se, si rrjedhojë e kriterëve të rrepta të tij mbi pranueshmërinë dhe në bazë të tyre,¹⁹⁵ Paneli i Gjykatës Supreme e rrëzoi menjëherë si të papranueshme kërkesën e Parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë në lidhje me interpretimin juridik të nenit 387 të KPK-së, duke vënë në dukje se Parashtruesi mund t’ia kishte parashtruar në mënyrë të arsyeshme këto argumente Panelit të Apelit.¹⁹⁶

88. Ndonëse mund të jetë e vërtetë që Paneli i Gjykatës Supreme shqyrtoi thelbin e argumenteve të z. Gucati lidhur me interpretimin juridik të nenit 387 të KPK-së,¹⁹⁷ të paraqitur në formën e duhur në kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë, Dhoma thekson se Paneli i Gjykatës Supreme shqyrtoi thelbin e argumenteve të z. Gucati dhe jo të Parashtruesit, të cilat u refuzuan shprehimisht për shkak të mosrespektimit të kërkesave formale prej tij.¹⁹⁸

89. Në këtë aspekt, Dhoma mban parasysh se, ndonëse argumentet e Parashtruesit ishin të ngjashme me argumentet e paraqitura nga z. Gucati që u shqyrtuan nga Paneli i Gjykatës Supreme, ato nuk ishin identike.¹⁹⁹ Faktikisht, në disa aspekte, Parashtruesi paraqiti argumente të ndryshme për të mbështetur qëndrimin e tij në lidhje me interpretimin e nenit 387 të KPK-së,²⁰⁰ që janë të njëjta me ato në Kërkesën Referuese të tij.²⁰¹ Rrjedhimisht, Paneli i Gjykatës Supreme nuk shqyrtoi thelbin faktik të ankesës që Parashtruesi i paraqiti Dhomës.²⁰² Për rrjedhojë, Dhoma gjykon se Parashtruesi nuk

¹⁹⁴ Shih më lart, para. 36.

¹⁹⁵ Vendimi për Mbrojtje të Ligjshmërisë, para. 9-10.

¹⁹⁶ Shih më lart, para. 50

¹⁹⁷ Shih më lart, para. 50-51.

¹⁹⁸ *Krahaso* ECtHR, *Ulemek v. Croatia*, përmendur më lart, para. 77.

¹⁹⁹ *Krahaso* Kërkesën e Haradinajt për Mbrojtje të Ligjshmërisë, para. 2(b), 21-30 me Kërkesën e Gucatit për Mbrojtje të Ligjshmërisë, para. 24-37, 44, 47.

²⁰⁰ Shih, për shembull Kërkesën e Haradinajt për Mbrojtje të Ligjshmërisë, para. 27.

²⁰¹ *Krahaso* Kërkesën e Haradinajt për Mbrojtje të Ligjshmërisë, para. 2(b), 21-30 me Kërkesën Referuese, para. 42.

²⁰² ECtHR, *Savickis and Others v. Latvia* [GC], përmendur më lart, para. 140

mund të pretendojë të përfitojë prej shqyrtimit të thelbit të argumenteve të z. Gucati nga Paneli i Gjykatës Supreme.

90. Po kështu, Dhoma i kushton vëmendje të veçantë faktit se Parashtruesi nuk ka shpjeguar pse nuk ia paraqiti siç duhej argumentet e tij në lidhje me nenin 387 të KPK-së Panelit të Apelit dhe, më pas, Panelit të Gjykatës Supreme. Dhoma gjithashtu thekson se nuk ka tregues se këto mjete juridike ishin, për ndonjë arsye, të papërshtatshme dhe joefektive në rrethanat konkrete të çështjes. Përkundrazi, sipas Dhomës, fakti se Paneli i Apelit dhe Paneli i Gjykatës Supreme e shqyrtuan në mënyrën e duhur thelbin e argumenteve të paraqitura nga z. Gucati, tregon për të kundërtën.²⁰³

91. Për rrjedhojë, nuk ka bazë për të sugjeruar se vendimi i Panelit të Gjykatës Supreme do të kishte qenë i njëjtë nëse Parashtruesi do t'i kishte respektuar kriteret formale dhe do t'i kishte dhënë Panelit të Gjykatës Supreme mundësinë për të shqyrtuar argumentet e tij.²⁰⁴ Po kështu, Parashtruesi nuk paraqiti, dhe Dhoma nuk vëren ndonjë rrethanë të veçantë që do ta lironte Parashtruesin nga detyrimi për shfrytëzimin e mjeteve juridike efekteve të parashikuara në ligj.²⁰⁵

92. Bazuar në sa më lart, Dhoma është e mendimit se ndonëse Parashtruesi u përpoq të shteronte një mjet juridik efektiv që përndryshe do të kishte qenë i efektshëm, neglizhenca e tij bëri që ai të mos i përmbushte kriteret formale për paraqitjen e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë. Rrjedhimisht, në përputhje me kriteret e përcaktuara në jurisprudencën e GJEDNJ-së dhe Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, sikurse shtjellohet në paragrafët 80-86 më lart, Dhoma konstaton se pretendimi i Parashtruesit në lidhje me interpretimin juridik të nenit 387 të KPK-së është i papranueshëm për shkak të mosshterimit të mjeteve juridike dhe se, në pajtim me

²⁰³ ECtHR, *P.C. v. Ireland*, no. 26922/19, 1 shtator 2022, para. 107. Shih gjithashtu Kosovë, Gjykata Kushtetuese, KI 108/18, përmendur më lart, para. 166-178.

²⁰⁴ *Krahaso* ECtHR, *Paketova and Others v. Bulgaria*, nos 17808/19 and 36972/19, 4 October 2022, para. 128; *D.H. and Others v. the Czech Republic* [GC], përmendur më lart, para. 122.

²⁰⁵ Shih ECtHR, *Sejdovic v. Italy* [GC], no. 56581/00, 1 March 2006, para. 43-55.

nenin 113(7) të Kushtetutës, nenin 49(3) të Ligjit dhe rregullën 20(1)(a) të DHSGJK-së, ai duhet të rrëzohet.

93. Sa i përket pretendimit të Parashtruesit në lidhje me interpretimin e nenit 392(2) të KPK-së nga dhomat penale, Dhoma vë në dukje se, duke qenë se Parashtruesi nuk i paraqiti në Dosjen e Apelit të gjitha argumentet dhe jurisprudencën në mbështetje të pikës të apelit të tij lidhur me interpretimin juridik të nenit 392(2) të KPK-së, Paneli i Apelit rrëzoi menjëherë këtë aspekt të apelit si të pabazë.²⁰⁶ Dhoma gjithashtu thekson se ishte kryesisht për këtë arsye që edhe Paneli i Gjykatës Supreme i rrëzoi menjëherë argumentet e Parashtruesit në lidhje me nenin 392(2) të KPK-së.²⁰⁷

94. Dhoma rikujton se nuk është detyrë e saj të trajtojë gabimet faktike ose ligjore që pretendohet se janë bërë nga dhomat penale, përveçse dhe vetëm nëse këto gabime mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë. Dhoma vë në dukje vetëm se, në kundërshtim me pretendimet e Parashtruesit, Paneli i Apelit nuk shqyrtoi thelbin e argumenteve të njëjta që ai më pas kërkoi t'ia paraqiste Panelit të Gjykatës Supreme, sepse ato nuk u trajtuan specifikisht nga Paneli i Apelit në kontekstin e apelit të z. Gucati.²⁰⁸

95. Rrjedhimisht, edhe duke supozuar se Parashtruesi mund të pretendonte që të përfitonte nga shqyrtimi i thelbit të argumenteve të z. Gucati në lidhje me interpretimin juridik të nenit 392(2) të KPK-së, në rastin konkret nuk ishte kështu. Për më tepër, Dhoma thekson se në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, z. Gucati nuk ngriti përsëri argumentet e paraqitura në apel dhe Paneli i Gjykatës Supreme nuk shqyrtoi, as për Parashtruesin, as për z. Gucati, thelbin e pretendimit të ngritur nga Parashtruesi para Dhomës në lidhje me nenin 392(2) të KPK-së.²⁰⁹

96. Së fundi, Dhoma vë në dukje se nuk ka asnjë tregues se mjetet juridike të disponueshme para Panelit të Apelit dhe Panelit të Gjykatës Supreme ishin, për

²⁰⁶ Shih më lart, para. 38.

²⁰⁷ Shih më lart, para. 53.

²⁰⁸ Shih më lart, para. 39.

²⁰⁹ Shih më lart, para. 54.

ndonjë arsye, të pamjaftueshme dhe joefektive në rrethanat konkrete të çështjes, apo se kishte ndonjë rrethanë të veçantë që e lironte Parashtruesin nga detyrimi për shterimin e mjeteve juridike të përcaktuara në ligj. Për këtë arsye, Dhoma është e mendimit se, ndër të tjera, mospërmblidhja nga Parashtruesi e kriterëve formale të nenit 48(6)-(7) të Ligjit dhe rregullave 179(1) dhe 193(3) të Rregullores, rezultoi në papranueshmërinë e argumenteve të tij lidhur me interpretimin juridik të nenit 392(2) të KPK-së si nga Paneli i Apelit, ashtu edhe nga Paneli i Gjykatës Supreme. Rrjedhimisht, Dhoma konstaton se pretendimi i Parashtruesit lidhur me interpretimin e gjerë të nenit 392(2) të KPK-së, duhet të konstatohet gjithashtu i papranueshëm për shkak të mosshterimit të mjeteve juridike sipas nenit 113(7) të Kushtetutës, nenit 49(3) të Ligjit dhe rregullës 20(1)(a) të Rregullores së DHSGJS-së.

97. Sa i përket pretendimit lidhur me interpretimin e nenit 401(1) të KPK-së, Dhoma vë në dukje se Parashtruesi ka shteruar siç duhet mjetet juridike të parapara në ligj.²¹⁰ Për më tepër, ndonëse nuk është detyrë e Dhomës të trajtojë gabimet faktike ose ligjore që pretendohet se janë bërë nga dhomat penale, përveçse dhe vetëm nëse këto gabime mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë, Dhoma vëren se Parashtruesi në thelb u ankua se u shpall fajtor në bazë të një interpretimi pajustificueshmërisht të gjerë të nenit 401(1) të KPK-së, i cili, në kundërshtim me nenin 33(1) të Kushtetutës dhe nenin 7 të Konventës, ishte i tillë që veprimet e tij nuk përbënin vepër penale në kohën e kryerjes së tyre.

98. Dhoma mban parasysh se në bazë të dispozitave të lartpërmendura, ajo ka detyrën të verifikojë nëse shpallja e Parashtruesit fajtor kishte bazë ligjore në kohën përkatëse dhe nëse përfundimi i arritur nga dhomat penale ishte në përputhje me parimin e ligjshmërisë.²¹¹ Rrjedhimisht, dhe duke qenë se nuk mund të përcaktohen

²¹⁰ Shih më lart, para. 34-35, 47-48.

²¹¹ Shih ECtHR, *Jasutis and Šimaitis v. Lithuania*, nos 28186/19 and 29092/19, 12 December 2023, para. 112-114; *Vasiliauskas v. Lithuania* [GC], përmendur më lart, para. 160-161. Shih gjithashtu Kosovë, Gjykata Kushtetuese, *Kërkesë për vlerësim të Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme PML. nr. 325/2020 të 16 dhjetorit 2020*, KI 11/21, Aktvendim për papranueshmëri, 25 mars 2021 (31 maj 2021), para. 81-83.

arsye të tjera për papranueshmërinë, Dhoma konstaton se ankesa e Parashtruesit mbi këtë aspekt duhet të shpallet e pranueshme dhe të shqyrtohet themelësia e saj.

B. PRETENDIMI PËR SHKELJE TË NENIT 32(1) TË KUSHTETUTËS DHE NENIT 6(1) TË KONVENTËS

1. Parashtrimet

99. Duke iu referuar çështjes gjyqësore në GJEDNJ *Ramanauskas k. Lituanisë* (*Ramanauskas v. Lithuania* [GC]),²¹² Parashtruesi argumentoi se, nëse pretendimet e shtytjes për kryerje të veprës penale nuk janë tërësisht të pagjasa, i takon prokurorisë të provojë se nuk ka pasur shtytje dhe, në mungesë të provave të tilla, është detyrë e autoriteteve gjyqësore që të shqyrtojnë faktet e çështjes dhe të ndërmarrin hapat e nevojshëm për të zbuluar të vërtetën.²¹³ Gjithashtu, duke u mbështetur në jurisprudencën e GJEDNJ-së, ndër të tjera, në çështjen gjyqësore *Matanović k. Kroacisë* (*Matanović v. Croatia*),²¹⁴ Parashtruesi pretendoi se dhomat penale zbatuan standardin ligjor të gabuar dhe parashtroi se standardi i zbatueshëm ishte argumenti për ekzistencën *prima facie* të shtytjes për kryerje të veprës penale, dhe jo detyrimi për të paraqitur prova *prima facie* të shtytjes për kryerje të veprës penale, sikurse u interpretua nga dhomat penale.²¹⁵

100. Parashtruesi pretendoi se konstatimi për ekzistencën *prima facie* të shtytjes për kryerje të veprës penale mund të bëhet edhe në mungesë të përfshirjes së forcave të rendit dhe se provat të cilat, në tërësi, bëjnë që shtytja për kryerje të veprës penale të mos jetë tërësisht e pagjasë, duhet të jenë të mjaftueshme për ta përmbushur këtë standard.²¹⁶ Ai argumentoi se, duke përdorur standard të ndryshëm nga ai që kërkon jurisprudenca e GJEDNJ-së, faktikisht dhomat penale e përmbysën detyrimin e

²¹² Kërkesa Referuese, para. 52, i referohet ECtHR, *Ramanauskas v. Lithuania* [GC], no. 74420/01, 5 February 2008, para. 70.

²¹³ Kërkesa Referuese, para. 52.

²¹⁴ Kërkesa Referuese, para. 54, 57, i referohet ECtHR, *Matanović v. Croatia*, no. 2742/12, 4 April 2017, para. 131.

²¹⁵ Kërkesa Referuese, para. 54, 57.

²¹⁶ Kërkesa Referuese, para. 55-57.

vërtetimit dhe shkelën të drejtën e tij për gjykim të drejtë.²¹⁷

101. Parashtruesi gjithashtu pretendoi se, në kërkimin e provave *prima facie* të përfshirjes së ZPS-së, dhomat penale nuk morën parasysh se shtytja për kryerje të veprës penale mund të ishte organizuar nga Serbia.²¹⁸ Në këtë aspekt, ai parashtroi se disa prova që pretendon se provonin pretendimin e shtytjes për kryerje të veprës penale nuk u nxorën në gjykim dhe, në përputhje me çështjen gjyqësore të GJEDNJ-së *Eduard dhe Lewis k. Mbretërisë së Bashkuar (Edward and Lewis v. the United Kingdom)* [GC],²¹⁹ argumentoi se kjo shkaktoi shkelje procedurale të nenit 6(1) të Konventës.²²⁰ Së fundi, Parashtruesi gjithashtu u ankua për faktin se nuk kishte mundësi apelimi të ndërmjetëm kundër vendimeve të Panelit të Apelit me të cilat u rrëzuan kërkesat për prova që ishin thelbësore për pretendimin e shtytjes për kryerje të veprës penale.²²¹

102. ZPS-ja argumentoi se, sa i përket ankesës së Parashtruesit lidhur me interpretimin e nga dhomat penale të standardit të zbatueshëm *prima facie* për pretendimet e shtytjes për kryerje të veprës penale, ankesa ishte e papranueshme sepse në lidhje me ankesat në bazë të nenit 31(2) të Kushtetutës dhe nenit 6(1) të Konventës mund të shqyrtohej vetëm aspekti procedural dhe jo ai material i trajtimit me drejtësi.²²² ZPS-ja gjithashtu argumentoi se nuk ishte krijuar perceptim për shkelje dhe, për rrjedhojë, ankesa ishte e papranueshme.²²³ Në veçanti, ZPS-ja ishte e mendimit se interpretimi nga Parashtruesi i standardit të zbatueshëm i shtytjes për kryerje të veprës penale ishte aq i ulët, saqë në thelb përjashtonte çdo detyrim për paraqitje të provave dhe keqinterpretonte jurisprudencën e GJEDNJ-së.²²⁴

103. Së fundi, ZPS-ja pretendoi se argumentet e Parashtruesit në lidhje me

²¹⁷ Kërkesa Referuese, para. 58.

²¹⁸ Kërkesa Referuese, para. 59-62.

²¹⁹ Kërkesa Referuese, para. 64, i referohet ECtHR, *Edward and Lewis v. the United Kingdom* [GC], nos 39647/98 and 40461/98, 27 October 2004, para. 46.

²²⁰ Kërkesa Referuese, para. 64.

²²¹ Kërkesa Referuese, para. 65.

²²² Parashtrimet e ZPS-së, para. 31.

²²³ Parashtrimet e ZPS-së, para. 31.

²²⁴ Parashtrimet e ZPS-së, para. 33.

mosnxjerrjen e provave ishin të pabazuara dhe ai nuk përmendi përpjekjet e mëdha të bëra nga dhomat penale për garantimin e të drejtave procedurale të tij.²²⁵ ZPS-ja parashtroi se këto argumente gjithashtu duhet të shpallehin të papranueshme, sepse Parashtruesi nuk bëri të ditur asnjë arbitraritet flagrant dhe të qartë prej dhomave penale në zbatimin e kornizës ligjore për nxjerrjen e provave.²²⁶

104. Në kundërpërgjigje, Parashtruesi përsëriti se sipas këtij standardi tërësisht të pagjasë, prokuroria duhej të provonte se nuk kishte pasur shtytje dhe se, duke gabuar në zbatimin e standardit ligjor, dhomat penale përmbysën detyrimin e vërtetimit në lidhje me pretendimin e shtytjes për kryerje të veprës penale nga ZPS-ja.²²⁷

2. Vlerësimi i Dhomës

105. Fillimisht, Dhoma vë në dukje se, në parim, Parashtruesi duket se ka përmbushur shumicën e kriterëve të pranueshmërisë të përcaktuara në Kushtetutë, në Ligj dhe në Rregulloren e DHSGJK-së. Sidoqoftë, në bazë të rregullës 14(f) të Rregullores së DHSGJK-së, Dhoma gjithsesi mund ta shpallë të papranueshme kërkesën referuese, ose pjesë të veçanta të saj, për arsye që lidhen me shqyrtimin e themelësisë së saj. Më konkretisht, një kërkesë referuese, ose një pretendim konkret në kërkesën referuese, mund të konsiderohet i papranueshëm në qoftë se aty nuk ka asnjë parashtrim që ngre aspektin e perceptimit për shkelje të së drejtës kushtetuese. Në kuadër të këtij vlerësimi, Dhoma përsëri i referohet dhe zbaton standardin e GJEDNJ-së, sikurse është e detyruar ta zbatojë sipas nenit 53 të Kushtetutës.²²⁸

106. Lidhur me ankesën e Parashtruesit sipas nenit 32(1) të Kushtetutës, Dhoma vëren se, në thelb, Parashtruesi u ankua se u shty nga ZPS-ja të kryente vepra penale që çuan në shpalljen e tij fajtor dhe se dhomat penale përmbysën detyrimin e

²²⁵ Parashtrimet e ZPS-së, para. 32.

²²⁶ Parashtrimet e ZPS-së, para. 32.

²²⁷ Parashtrimet e Parashtruesit të Kërkesës, para. 37.

²²⁸ Kosovë, Gjykata Kushtetuese, *Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Plm. nr. 76/2020, të 8 prillit 2020*, KI 110/20, Aktvendim për papranueshmëri, 3 nëntor 2021 (22 nëntor 2021), para. 44-48; KI 11/21, përmendur më lart, para. 42-46.

vërtetimit duke i kërkuar që të paraqiste prova *prima facie* të shtytjes për kryerje të veprës penale, në vend që të përdornin standardin krejtësisht të pagjasë që ia ngarkonte detyrimin e vërtetimit ZPS-së. Fillimisht, Dhoma rikujton se, në bazë të jurisprudencës së GJEDNJ-së, shtytja për kryerje të veprës penale ose

nxitja nga policia ndodh kur zyrtarët e përfshirë [në një operacion të fshehtë] – qoftë anëtarë të forcave të sigurisë ose persona që veprojnë sipas udhëzimeve të tyre – nuk kufizohen në hetimin e veprimtarisë kriminale në një mënyrë në thelb pasive, por ushtrojnë mbi subjektin [e hetimit] një ndikim të tillë që nxit kryerjen e një veprë penale që përndryshe nuk do të ishte kryer, me qëllim që të bëhet i mundur vërtetimi i veprës penale, domethënë, për sigurimin e provave dhe nisjen e ndjekjes penale.²²⁹

107. Dhoma vë në dukje se shqyrtimi i ankesave të shtytjes për kryerje të veprës penale nga GJEDNJ-ja u përcaktua mbi bazën e dy standardeve, konkretisht standardit material dhe standardit procedural për shtytje.²³⁰ Në kontekstin e standardit material, si hap i parë, GJEDNJ-ja u përpoq të përcaktonte, në bazë të materialit të disponueshëm, nëse vepra penale do të ishte kryer pa ndërhyrjen e autoriteteve, domethënë, nëse hetimi ishte në thelb pasiv. Për këtë qëllim, GJEDNJ-ja, ndër të tjera, shqyrtoi arsyet për kryerjen e operacionit të fshehtë, si dhe sjelljen dhe veprimet e autoriteteve që e zbatuan atë.²³¹

108. Në kontekstin e standardit procedural për shtytje, GJEDNJ-ja shqyrtoi mënyrën se si gjykatat (vendore) trajtuan pretendimin për shtytje të një parashtruesi dhe, në veçanti, nëse respektuan parimet e procesit ballafaques dhe të barazisë midis palëve.²³² Konkretisht, në lidhje me këtë, GJEDNJ-ja ka konstatuar se i takon prokurorisë të provojë se nuk ka pasur shtytje për kryerje të veprës penale, përveç nëse pretendimet e të akuzuarve janë tërësisht të pagjasa.²³³

109. Sidoqoftë, Dhoma thekson se gjatë vlerësimit nga GJEDNJ-ja të një ankese për

²²⁹ ECtHR, *Ramanauskas v. Lithuania* [GC], përmendur më lart, para. 55.

²³⁰ Shih, për shembull ECtHR, *Matanović v. Croatia*, përmendur më lart, para. 122.

²³¹ ECtHR, *Matanović v. Croatia*, përmendur më lart, para. 123-124.

²³² ECtHR, *Matanović v. Croatia*, përmendur më lart, para. 125-130.

²³³ ECtHR, *Bannikova v. Russia*, no. 18757/06, 4 nëntor 2010, para. 54, 73; *Ramanauskas v. Lithuania* [GC], përmendur më lart, para. 69-70.

shtytje, një faktor paraprak që u shqyrtua lidhej me ekzistencën e një pretendimi të argumentueshëm se parashtruesi i kërkesës kishte qenë objekt i shtytjes nga autoritetet e rendit dhe të ligjit. Faktikisht, GJEDNJ-ja u shpreh se nuk do të vijonte të bënte vlerësimin sipas standardit material dhe/ose procedural të zbatueshëm për shtytjen, përveç nëse do të bindej se situata nën shqyrtim përfshihej *prima facie* në kategorinë e rasteve të shtytjes për kryerje të veprës penale.²³⁴

110. Në lidhje me faktet e çështjes, Dhoma fillimisht rikujton se argumenti i shtytjes për kryerje të veprës penale sipas nenit 33(1) të Kushtetutës dhe nenit 6(1) të Konventës mund të paraqitet vetëm në kontekstin e një operacioni të fshehtë me përfshirjen e punonjësve të rendit dhe të ligjit ose personave që vepronin sipas udhëzimeve të tyre. Ankesat në lidhje me shtytjen për kryerje të veprës penale nga persona që nuk veprojnë sipas udhëzimeve ose nën kontrollin e autoriteteve të rendit dhe të ligjit shqyrtohen sipas rregullave të përgjithshme për administrimin e provave, dhe jo si shtytje për kryerje të veprës penale.²³⁵

111. Dhoma vëren se, ndonëse ZPS-ja mohoi se po kryente hetime në lidhje me Parashtruesin në atë kohë, Parashtruesi pretendoi se materiali konfidencial i dorëzuar në selinë e OVL-UÇK-së, ose ishte nxjerrë qëllimisht nga ZPS-ja, ose, si alternativë, mund të kishte ardhur nga Serbia.²³⁶ Dhoma gjithashtu thekson se në konstatimet e Trupit Gjykses nuk kishte asgjë që të sugjeronte se punonjësit e rendit dhe të ligjit, apo persona që vepronin sipas udhëzimeve të tyre, ishin përfshirë në tri dorëzimet e materialeve në OVL-UÇK.²³⁷ Sidoqoftë, edhe nëse supozohet, për hir të argumentit, se burimi i nxjerrjes së informacionit ishte ZPS-ja apo persona që vepronin sipas udhëzimeve të saj, nga këndvështrimi i Dhomës, *prima facie*, situata nën shqyrtim nuk përfshihet në kategorinë e shtytjes për kryerje të veprës penale.

²³⁴ Shih ECtHR, *Matanović v. Croatia*, përmendur më lart, para. 131-132.

²³⁵ ECtHR, *Shannon v. United Kingdom* (dec.), no. 67537/01, 6 April 2014, pp 10-13.

²³⁶ Kërkesa Referuese, para. 59. Shih gjithashtu Aktgjykimin, para. 856.

²³⁷ Aktgjykimi, para. 859-862.

112. Më konkretisht, Dhoma vë në dukje se Parashtruesi asnjëherë nuk pretendoi se personat e panjohur që dorëzuan tre grupet me material konfidencial, apo dikush tjetër, qoftë në kohën e dorëzimeve apo më pas, tentuan ta detyronin që të kryente veprimet e paligjshme.²³⁸ Përkundrazi, Parashtruesi ishte thjesht marrës i dokumenteve konfidenciale që iu dorëzuan nga persona të panjohur. Rrjedhimisht, Parashtruesi duhet të reagoje në mënyrë të ligjshme ndaj ngjarjeve në fjalë. Faktikisht, Parashtruesi, me vullnet të lirë, zgjodhi të reagoje në mënyrë që ishte qëllimisht e paligjshme.²³⁹

113. Rrjedhimisht, Dhoma gjykon se faktor vendimtar në kryerjen e veprave penale për të cilat Parashtruesi u shpall fajtor, ishin veprimet e Parashtruesit dhe jo veprimet e punonjësve të rendit dhe të ligjit apo personave që vepronin sipas udhëzimeve të tyre – edhe në qoftë se do të supozohej se do të kishte pasur të tilla.²⁴⁰ Bazuar në këto arsye, Dhoma konstaton se situata e Parashtruesit qartësisht nuk përfshihet në kategorinë e shtytjes për kryerje të veprës penale dhe rrjedhimisht, edhe *prima facie*, nuk duhet të shqyrtohet si e tillë.

114. Dhoma është e mendimit se dhomat penale, në faza të ndryshme të procesit, ngatërrojnë standardin *prima facie* me standardin ‘tërësisht i pagjasë’ që GJEDNJ-ja e shqyrton vetëm pasi është përmbushur i pari.²⁴¹ Megjithatë, Dhoma konstaton se ky ngatërrim standardesh në fund të fundit nuk pati pasoja mbi të drejtat e Parashtruesit sipas nenit 32(1) të Kushtetutës dhe nenit 6(1) të Konventës, sepse i dha atij më shumë garanci procedurale dhe jo më pak. Faktikisht, edhe në mungesë të përmbushjes së standardit *prima facie* për shtytje për kryerje të veprës penale, Trupi Gjykyes bëri të

²³⁸ Aktgjykimi, para. 856-857.

²³⁹ Shih më lart, para. 14, me referenca të mëtejshme.

²⁴⁰ Shih, për shembull ECtHR, *Volkov and Adamskiy v. Russia*, nos 7614/09 and 30863/10, 26 March 2015, para. 36-46; *Trifontsov v. Russia* (dec.), no. 12025/02, 9 October 2012, para. 32-35; *Kuzmickaja v. Lithuania* (dec.), no. 27968/03, 10 June 2008, p. 7.

²⁴¹ Aktgjykimi, para. 837, 889-890; Aktgjykimi i Apelit, para. 363-365; Vendimi për Mbrojtje të Ligjshmërisë, para. 92-93.

pamundurën që t'i jepte Parashtruesit mundësinë të paraqiste pretendimin e shtytjes për kryerje të veprës penale dhe bëri vlerësim të plotë të atij pretendimi.²⁴²

115. Në mënyrë të ngjashme, si Paneli i Apelit, ashtu edhe Paneli i Gjykatës Supreme, i shqyrtuan siç duhet argumentet e Parashtruesit në lidhje me pretendimin e shtytjes për kryerje të veprës penale dhe dhanë vlerësim të arsyetuar për refuzimin e tyre.²⁴³

Në këto rrethana, Dhoma nuk vuri re asnjë shkelje të dukshme të të drejtave të Parashtruesit të përcaktuara në nenin 32(1) të Kushtetutës dhe në nenin 6(1) të Konventës. Rrjedhimisht, kjo ankesë duhet të shpallet e papranueshme sipas rregullës 14(f) të Rregullores së DHSGJK-së.

C. PRETENDIMI PËR SHKELJE TË NENIT 40 TË KUSHTETUTËS DHE NENIT 10 TË KONVENTËS

1. Parashtrimet

116. Parashtruesi argumentoi se dhomat penale gabuan në përkufizimin që i bënë interesit publik dhe, për rrjedhojë, nuk morën parasysh faktin se qëndrimi i Serbisë në vite ndaj Kosovës, si dhe numri i shumtë i kontakteve midis TFHS-së/ZPS-së dhe zyrtarëve serbë, disa prej të cilëve kishin shërbyer nën regjimin e Millosheviqit, dëmtuan edhe pavarësinë, paanësinë dhe integritetin e hetimeve.²⁴⁴ Në këtë aspekt, Parashtruesi gjithashtu pretendoi se dhomat penale e penguan të mbështetej në disa dëshmitarë që ishin në gjendje të ofronin dëshmi relevante për argumentet mbrojtëse të tij në lidhje me interesin publik dhe gabuan që kufizuan pjesë kyçe të atyre dëshmive i lejuan.²⁴⁵

117. Sipas Parashtruesit, përfundimi se përgjegjësia penale e tij nuk mund të përjashtohet mbi bazën e faktorit të interesit publik përbënte shkelje të së drejtës së tij për lirinë e shprehjes.²⁴⁶ Së fundi, Parashtruesi u ankua se dhomat penale nuk morën parasysh nëse kishte mënyra të tjera përveç ndjekjes penale për përmbushjen e

²⁴² Shih, konkretisht, Aktgjykimin, para. 841-850, 854-890.

²⁴³ Aktgjykimi i Apelit, para. 361-374; Vendimi për Mbrojtje të Ligjshmërisë, para. 91-96.

²⁴⁴ Kërkesa Referuese, para. 67, 70, 78.

²⁴⁵ Kërkesa Referuese, para. 71-77.

²⁴⁶ Kërkesa Referuese, para. 79.

qëllimeve të përcaktuara në nenin 10(2) të Konventës.²⁴⁷

118. ZPS-ja argumentoi se kjo ankesë duhet të rrëzohet si e papranueshme.²⁴⁸ Në veçanti, ZPS-ja parashtroi se mjeti juridik që kërkoi Parashtruesi nga Paneli i Gjykatës Supreme ishte qartësisht joefektiv dhe, për rrjedhojë, ankesës që paraqiti Dhomës i kishte kaluar afati.²⁴⁹ Sidoqoftë, ZPS-ja argumentoi se interesi publik i pretenduar i Parashtruesit për zbulimin e informacionit konfidencial në fjalë zhbëhej nga nevoja parësore për garantimin e sigurisë së dëshmitarëve (të mbrojtur) të krimeve ndërkombëtare.²⁵⁰

119. Në kundërpërgjigje, Parashtruesi përsëriti argumentet e paraqitura në Kërkesën Referuese në lidhje me domosdoshmërinë dhe proporcionalitetin e ndjekjes penale për përmbushjen e qëllimeve të përcaktuara në nenin 10(2) të Konventës.²⁵¹

2. Vlerësimi i Dhomës

120. Fillimisht, Dhoma vë në dukje se Parashtruesi, në thelb u ankua se, duke mos përjashtuar përgjegjësinë penale të tij mbi bazën e faktorit të interesit publik, dhomat penale shkelën të drejtën e tij për lirinë e shprehjes sipas nenit 40 të Kushtetutës dhe nenit 10 të Konventës. Dhoma gjithashtu rikujton se Trupi Gjykues e shqyrtoi pretendimin e interesit publik të Parashtruesit në kontekstin e së drejtës për lirinë e shprehjes dhe e vlerësoi si justifikim të mundshëm që mund të ndikonte përgjegjësinë penale individuale të tij.²⁵²

121. Paneli i Apelit shqyrtoi në të njëjtën mënyrë argumentin mbrojtës të interesit publik dhe konstatoi se, në qoftë se vërtetohej, do të shërbente si arsye për të përjashtuar përgjegjësinë penale individuale të Parashtruesit.²⁵³ Në këtë aspekt, Dhoma vë në dukje se, në bazë të nenit 48(6)-(7) të Ligjit, shkelja e të drejtës penale

²⁴⁷ Kërkesa Referuese, para. 81-82.

²⁴⁸ Parashtrimet e ZPS-së, para. 35.

²⁴⁹ Parashtrimet e ZPS-së, para. 35.

²⁵⁰ Parashtrimet e ZPS-së, para. 36.

²⁵¹ Parashtrimet e Parashtruesit të Kërkesës, para. 39.

²⁵² Shih më lart, para. 28.

²⁵³ Shih më lart, para. 44.

mund t'i paraqitet Panelit të Gjykatës Supreme, ndër të tjera, nëse ekzistojnë rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale.²⁵⁴ Nga kjo rrjedh se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është një nga mjetet juridike që Parashtruesi duhet të përdorë për shterimin e të gjitha mjeteve juridike lidhur me pretendimin për shkelje.²⁵⁵

122. Gjithsesi, Dhoma vëren se argumentet që Parashtruesi i paraqiti Panelit të Gjykatës Supreme kishin kuadër më të kufizuar se ato të paraqitura në Kërkesën Referuese të tij dhe nuk trajtonin mospërputhshmërinë e pretenduar të vendimit për fajësinë penale të Parashtruesit me nenin 40 të Kushtetutës dhe/ose nenin 10 të Konventës.²⁵⁶ Në veçanti, Parashtruesi pretendoi shkelje të konsiderueshme të së drejtës së tij për gjykim të drejtë sipas nenit 21(2) të Ligjit mbi bazën e mosmarrjes parasysh nga Trupi Gjykues të disa rrethanave faktike në përkufizimin e interesit publik, sikurse u konfirmua më pas nga Paneli i Apelit.²⁵⁷

123. Dhoma gjithashtu vë në dukje se Paneli i Gjykatës së Apelit rrëzoi menjëherë si të papranueshme argumentet e Parashtruesit në lidhje me argumentin mbrojtës të interesit publik për një numër arsyes, përfshirë sepse ai nuk evidentoi se cila rregull procedurale ishte shkelur në mënyrë thelbësore dhe sepse, në kundërshtim me kriteret në nenin 48(7) të Ligjit dhe në rregullën 193(3) të Rregullores, argumentet e tij ishin të llojit faktik dhe jo juridik.²⁵⁸

124. Duke rikujtuar parimet e përmendura në paragrafët 80-86 më lart lidhur me detyrimin për shterimin e mjeteve juridike, Dhoma është e mendimit se Parashtruesi nuk i paraqiti Panelit të Gjykatës Supreme, qoftë shprehimisht apo në thelb, të njëjtat argumente që i paraqiti Dhomave. Sa u përket atyre pak argumenteve që Parashtruesi faktikisht i paraqiti, Dhoma thekson se edhe ato ishin rrëzuar menjëherë nga Paneli i Gjykatës Supreme për shkak të mosrespektimit të kriterëve formale të përcaktuara në

²⁵⁴ Vendimi për Mbrojtje të Ligjshmërisë, para. 17.

²⁵⁵ Shih më lart, para. 81.

²⁵⁶ *Krahaso* Kërkesën e Haradinajt për Mbrojtje të Ligjshmërisë, para. 75 me Kërkesën Referuese, para. 67-83 dhe Parashtrimet e Parashtruesit të Kërkesës, para. 39.

²⁵⁷ Shih më lart, para. 58.

²⁵⁸ Shih më lart, para. 59.

Ligj dhe në Rregullore. Rrjedhimisht, mosparaqitja sipas rregullave nga prej Parashtruesit e ankesës së tij para Panelit të Gjykatës Supreme, i hoqi atij mundësinë e shqyrtimit dhe potencialisht të korrigjimit të shkeljes së pretenduar. Së fundi, Dhoma thekson se nuk ka tregues se mjeti juridik i disponueshëm për Panelin e Gjykatës Supreme ishte, për ndonjë arsye, i pamjaftueshëm dhe joefektiv në rrethanat konkrete të çështjes, ose se ekzistonin rrethana të veçanta që e lironin Parashtruesin nga detyrimi për shterimin e mjeteve juridike efektive të përcaktuara në ligj.

125. Rrjedhimisht, Dhoma konstaton se ankesa e Parashtruesit sipas nenit 40 të Kushtetutës dhe nenit 10 të Konventës duhet të deklarohet e papranueshme për shkak të mosshterimit të mjeteve juridike sipas nenit 113(7) të Kushtetutës, nenit 49(3) të Ligjit dhe rregullës 20(1)(a) të Rregullores së DHSGJK-së.

D. PËRFUNDIM

126. Bazuar në sa më lart, Dhoma konstaton se ankesa e Parashtruesit sipas nenit 33(1) të Kushtetutës dhe nenit 7 të Konventës, në veçanti, sa u përket pretendimeve të Parashtruesit lidhur me interpretimin juridik të neneve 387 dhe 392(2) të KPK-së, duhet të shpallet e papranueshme për shkak të mosshterimit të mjeteve juridike në përputhje me nenin 113(7) të Kushtetutës, nenin 49(3) të Ligjit, si dhe rregullën 20(1)(a) të Rregullores së DHSGJK-së.

127. Po kështu, Dhoma konstaton se ankesa e Parashtruesit sipas nenit 40 të Kushtetutës dhe nenit 10 të Konventës, bazuar në të njëjtat arsye për mosshterimin e mjeteve juridike, duhet të shpallet e papranueshme sipas nenit 113(7) të Kushtetutës, nenit 49(3) të Ligjit dhe rregullës 20(1)(a) të Rregullores së DHSGJK-së.

128. Gjithashtu, sa i përket ankesës së Parashtruesit lidhur me shtytjen për kryerje të veprës penale sipas nenit 33(2) të Kushtetutës dhe nenit 6(1) të Konventës, Dhoma konstaton se nuk duket se tregon shkelje të të drejtave kushtetuese të Parashtruesit. Për rrjedhojë, kjo pjesë e Kërkesës Referuese të Parashtruesit duhet të shpallet e papranueshme sipas rregullës 14(f) të Rregullores së DHSGJK-së.

129. Së fundi, Dhoma konstaton se ankesa e Parashtruesit sipas nenit 33(1) të Kushtetutës dhe nenit 7 të Konventës, sa u përket pretendimeve të tij në lidhje me interpretimin juridik të nenit 401(1) të KPK-së, është e papranueshme dhe duhet të shqyrtohet mbi themelësinë e saj.

VII. THEMELËSIA

A. PRETENDIMI PËR SHKELJE TË NENIT 33(1) TË KUSHTETUTËS DHE NENIT 40 TË KONVENTËS

1. Parashtrimet

130. Parashtruesi argumentoi se interpretimi pajustificueshmërisht i gjerë prej dhomave penale i nenit 401(1) të KPK-së shkeli parimin e ligjshmërisë të përcaktuar në nenin 33(1) të Kushtetutës dhe nenit 7 të Konventës.²⁵⁹ Në veçanti, Parashtruesi argumentoi se, duke zgjeruar fushëveprimin e nenit 401(1) të KPK-së për të përfshirë kërcënime të rënda ndaj personave të tretë, vepra penale nuk ishte as e disponueshme, as e parashikueshme në kohën e kryerjes së saj. Si rrjedhojë, Parashtruesi pretendoi se veprimet e tij nuk përbënin vepër penale në kohën që lidhet me akuzat dhe argumenton se, duke i konsideruar si të tilla, dhomat penale shkelën parimin e ligjshmërisë, në veçanti formulimin e kriterit *lex stricta* dhe ndalimin e interpretimit me analogji *in malam partem*.²⁶⁰

131. ZPS-ja pretendoi se interpretimi i nenit 401(1) të KPK-së prej dhomave penale ishte në pajtueshmëri të plotë me Kushtetutën dhe Konventën.²⁶¹ Në veçanti, ZPS-ja argumentoi se parimi i ligjshmërisë ende lejon interpretimin juridik të dispozitave ligjore të zbatueshme, se neni 401(1) i KPK-së mbulon qartazi çdo kërcënim të rëndë që mund të pengojë një person zyrtar dhe se Parashtruesi nuk paraqiti asnjë burim ligjor në mbështetje për të kundërtën.²⁶² ZPS-ja u pajtua me interpretimin e nenit 401(1)

²⁵⁹ Kërkesa Referuese, para. 2(a), 28, 36, 50.

²⁶⁰ Kërkesa Referuese, para. 34-40.

²⁶¹ Parashtrimet e ZPS-së, para. 18.

²⁶² Parashtrimet e ZPS-së, para. 18, 20-21.

të KPK-së prej dhomave penale dhe argumentoi se ai ishte në përputhje të plotë me thelbin e dispozitës, si dhe i parashikueshëm.²⁶³

132. Parashtruesi u kundërpërgjigj duke i kundërshtuar argumentet e ZPS-së si të gabuara dhe tepër të gjera, si edhe pa bazë provuese.²⁶⁴

2. Vlerësimi i Dhomës

133. Fillimisht, Dhoma rikujton se Parashtruesi u ankua se, duke e shpallur fajtor për pengimin e personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare përmes kërcënimit të rëndë sipas nenit 401(1) të KPK-së, dhomat penale e interpretuan gjerë përkufizimin e asaj veprë penale, duke shkelur nenin 33(1) të Kushtetutës dhe nenin 7 të Konventës. Në bazë të nenit 53 të Kushtetutës, në shqyrtimin e themelësisë së ankesës së Parashtruesit, Dhoma u referohet parimeve të përgjithshme të përcaktuara në jurisprudencën e GJEDNJ-së.²⁶⁵

134. Në këtë aspekt, Dhoma rikujton se neni 33(1) i Kushtetutës përcakton si vijon:

Askush nuk mund të akuzohet ose të dënohet për asnjë vepër e cila, në momentin e kryerjes, nuk ka qenë e përcaktuar me ligj si vepër penale, me përjashtim të veprave të cilat, në kohën e kryerjes së tyre, sipas së drejtës ndërkombëtare përbënin gjenocid, krime lufte ose krime kundër njerëzimit.

135. Dhoma gjithashtu vë në dukje se neni 7 i Konventës po kështu përcakton se:

Askush nuk shpallet fajtor për veprime ose mosveprime të cilat nuk kanë qenë vepra penale sipas të drejtës shtetërore ose ndërkombëtare në kohën kur janë kryer. Po ashtu nuk jepet dënim më i rëndë se ai që ishte i zbatueshëm në kohën kur është kryer vepra penale.

136. Krahas sa më lart, Dhoma vë në dukje se neni 33(1) i Kushtetutës dhe neni 7 i Konventës përfshijnë, në terma të përgjithshme, parimin e ligjshmërisë, konkretisht se vetëm ligji mund të përkufizojë një krim dhe të parashkruajë dënimin.²⁶⁶ Ndonëse këto

²⁶³ Parashtrimet e ZPS-së, para. 21.

²⁶⁴ Parashtrimet e Parashtruesit të Kërkesës, para. 18-19.

²⁶⁵ Shih më lart, para. 67. Shih gjithashtu *Vendimin mbi Kërkesat Referuese të J. Krasniqit dhe K. Veselit në lidhje me Akuzat Penale*, para. 45, 75.

²⁶⁶ Shih, ndër të tjera, ECtHR, *Kafkaris v. Cyprus* [GC], no. 21906/04, 12 February 2008, para. 138; *Cantoni v. France* [GC], no. 17862/91, 15 November 1996, para. 29.

dispozita, në veçanti, pengojnë zgjerimin e kuadrit të veprave penale ekzistuese në veprime që më parë nuk ishin vepra penale, ato gjithashtu përcaktojnë parimin se interpretimi i së drejtës penale nuk duhet të zgjerohet në dëm të të akuzuarit, për shembull, përmes analogjisë.²⁶⁷

137. Për rrjedhojë, veprat penale duhet të përkufizohen qartë në ligj. Me fjalën “ligj”, neni 33(1) i Kushtetutës dhe neni 7 i Konventës nënkuptojnë kriteret cilësore, konkretisht kriteret për disponueshmërinë dhe parashikueshmërinë.²⁶⁸ Sikurse është përcaktuar në jurisprudencën e GJEDNJ-së dhe të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, këto kriterë përmbushen kur individ mund ta dijë nga formulimi i dispozitës përkatëse dhe, nëse është nevoja, me ndihmën e interpretimit të gjykatave dhe këshillim juridik profesional, se cilat veprime ose mosveprime e bëjnë penalisht përgjegjës dhe çfarë dënimi do t’i jepet për veprimet e kryera dhe/ose mosveprimet.²⁶⁹

138. Dhoma gjithashtu rikujton se dhe GJEDNJ-ja dhe Gjykata Kushtetuese e Kosovës në jurisprudencën e tyre kanë pranuar vazhdimisht se, sado qartë të jetë hartuar një dispozitë ligjore në çfarëdo sistemi ligjor, përfshirë atë penal, ekziston një element i pashmangshëm interpretimit gjyqësor, roli i të cilit është të qartësojë çdo aspekt të për të cilin ende ka dyshime.²⁷⁰ Faktikisht, sikurse Dhoma ka vënë në dukje më herët, neni 33(1) i Kushtetutës dhe neni 7 i Konventës nuk mund të interpretohen se e bëjnë të paligjshëm qartësimin gradual të rregullave mbi përgjegjësinë penale përmes interpretimit ligjor nga çështja në çështje, me kusht që zhvillimi që rezulton të jetë në

²⁶⁷ ECtHR, *Kafkaris v. Cyprus* [GC], përmendur më lart, para. 138; *Cantoni v. France* [GC], përmendur më lart, para. 29; Kosovë, Gjykata Kushtetuese, KI 11/21, përmendur më lart, para. 79.

²⁶⁸ ECtHR, *Korbely v. Hungary* [GC], no. 9174/02, 19 September 2008, para. 70; Kosovë, Gjykata Kushtetuese, KI 11/21, përmendur më lart, para. 80.

²⁶⁹ ECtHR, *Del Río Prada v. Spain* [GC], no. 42750/09, 21 October 2013, para. 79; Kosovë, Gjykata Kushtetuese, KI 11/21, përmendur më lart, para. 79.

²⁷⁰ ECtHR, *Kafkaris v. Cyprus* [GC], përmendur më lart, para. 141; Kosovë, Gjykata Kushtetuese, KI 01/19, përmendur më lart, para. 155. Shih gjithashtu *Vendimin mbi Kërkesat Referuese të J. Krasniqit dhe K. Veselit në lidhje me Akuzat Penale*, para. 77.

përputhje me thelbin e veprës penale dhe se mund të parashikohej në mënyrë të arsyeshme.²⁷¹

139. Së fundi, Dhoma rikujton se nuk është roli i saj të zëvendësojë dhomat penale në lidhje me vlerësimin e fakteve dhe klasifikimin ligjor të tyre, me kusht që ato të bazohen në vlerësimin e arsyeshëm të provave.²⁷² Brenda kornizës ligjore të DHS-së, si në çdo sistem ligjor, është kryesisht detyrë e dhomave penale që të vendosin në lidhje me çdo kërkesë për interpretimin e dispozitave ligjore të zbatueshme.²⁷³ Rrjedhimisht, roli i Dhomës kufizohet në përcaktimin nëse efektet e interpretimit në fjalë janë në përputhje me Kushtetutën dhe Konventën.²⁷⁴

140. Megjithatë, kompetencat e Dhomës për shqyrtim duhet të jenë më të mëdha kur vetë e drejta sipas nenit 33(1) të Kushtetutës dhe nenit 7 të Konventës, shkeljen e të cilës ngre Parashtruesi, kërkon që të ketë pasur bazë ligjore për verdiktin e fajësisë dhe dënimin.²⁷⁵ Për rrjedhojë, Dhoma duhet të shqyrtojë nëse kishte bazë ligjore në atë kohë për shpalljen fajtor të Parashtruesit dhe, në veçanti, duhet të bindet se përfundimi i arritur nga dhomat penale ishte në përputhje me nenin 33(1) të Kushtetutës dhe nenin 7 të Konventës.²⁷⁶

141. Në lidhje me rrethanat e kësaj çështjeje, Dhoma vëren se Parashtruesi nuk kundërshton faktin se neni 401(1) i KPK-së i vitit 2019 ishte në fuqi në kohën e kryerjes së veprimeve prej tij. Faktikisht, Dhoma thekson se pengimi i personave zyrtarë në

²⁷¹ *Vendimi mbi Kërkesat Referuese të J. Krasniqit dhe K. Veselit në lidhje me Akuzat Penale*, para. 77. Shih gjithashtu ECtHR, *Norman v. the United Kingdom*, no. 41387/17, 6 July 2021, para. 60; *Kononov v. Latvia* [GC], no. 36376/04, 17 May 2010, para. 185; *Kafkaris v. Cyprus*, përmendur më lart, para. 141; Kosovë Gjykata Kushtetuese, KI 01/19, përmendur më lart, para. 156.

²⁷² Po ashtu, shih më lart, para. 68-69, 97. Shih gjithashtu ECtHR, *Rohlena v. the Czech Republic* [GC], no. 59552/08, 27 January 2015, para. 51.

²⁷³ ECtHR, *Dallas v. the United Kingdom*, no. 38395/12, 11 February 2016, para. 71; Kosovë, Gjykata Kushtetuese, KI 11/21, përmendur më lart, para. 81.

²⁷⁴ ECtHR, *Norman v. the United Kingdom*, përmendur më lart, para. 61; *Rohlena v. the Czech Republic* [GC], përmendur më lart, para. 51; Kosovë, Gjykata Kushtetuese, KI 11/21, përmendur më lart, para. 81.

²⁷⁵ Shih më lart, para. 98, me referenca të mëtejshme në jurisprudencë.

²⁷⁶ ECtHR, *Yüksel Yalçinkaya v. Türkiye* [GC], no. 15669/20, 26 September 2023, para. 241; *Vasiliauskas v. Lithuania* [GC], përmendur më lart, para. 161; Kosovë, Gjykata Kushtetuese, KI 11/21, përmendur më lart, para. 83.

kryerjen e detyrave zyrtare përmes kërcënimit të rëndë, si i tillë, njihej qartë si veprë penale në KPK në periudhën përkatëse, pasi Parashtruesi i kishte kryer veprimet në fjalë gjatë shtatorit 2020.²⁷⁷ Rrjedhimisht, Dhoma është e mendimit se dispozita ishte mjaftueshmërisht e disponueshme për Parashtruesin.

142. Sidoqoftë, Parashtruesi argumentoi se dhomat penale përdorën një interpretim tepër të gjerë të veprës penale. Konkretisht, Parashtruesi vuri në pikëpyetje nëse verdikti i fajësisë së tij për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare përmes kërcënimit të rëndë kundër një personi tjetër dhe jo personit zyrtar që kryen detyrat zyrtare, ishte në përputhje me thelbin e veprës penale sipas nenit 401(1) të KPK-së dhe mund të parashikohej në mënyrë të arsyeshme nga Parashtruesi në kohën e ngjarjeve që çuan në procesin penal kundër tij.

143. Sa i përket përputhshmërisë së interpretimit të dhomave penale me thelbin e veprës penale, Dhoma duhet të përcaktojë nëse interpretimi ishte në pajtueshmëri me formulimin e dispozitës së legjislacionit penal në fjalë, të interpretuar në kontekstin përkatës, dhe nëse interpretimi ishte apo jo i paarsyeshëm.²⁷⁸ Në përcaktimin nëse interpretimi i dhomave penale ishte në përputhje me thelbin e veprës penale sipas nenit 401(1) të KPK-së, Dhoma vë në dukje se dhomat penale morën parasysh se “kërcënimi i rëndë” sipas nenit 401(1) të KPK-së, teksti i të cilit citohet në paragrafin 22 më lart, jo domosdoshmërisht duhej të drejtohej vetëm kundër “një personi zyrtar”, konkretisht zyrtarëve të DHS-së dhe të ZPS-së, si një gjykatës, një prokuror apo një hetues. Përkundrazi, u konstatua se kërcënimi i rëndë mund të drejtohej edhe kundër një personi apo objekti tjetër, nëse u krye me qëllimin për të penguar detyrat ose funksionet zyrtare të personit zyrtar.²⁷⁹

144. Dhoma vëren se, në arritjen e përfundimit të lartpërmendur, dhomat penale fillimisht shqyrtuan formulimin e nenit 401(1) të KPK-së. Në veçanti, dhomat penale

²⁷⁷ Shih më lart, para. 13-14.

²⁷⁸ Shih, për shembull ECtHR, *Jorgic v. Germany*, no. 74613/01, 12 July 2007, para. 104-107.

²⁷⁹ Shih më lart, para. 23, 35, 48, me referenca të mëtejshme.

konstatuan se në formulimin e tij nuk ka asgjë që sugjeron se kërcënimi i rëndë duhet të drejtohet vetëm ndaj personit zyrtar.²⁸⁰ Dhomat penale gjykuan se dispozita do të ishte formuluar ndryshe, në një mënyrë që të kërkonte shprehimisht që kërcënimi i rëndë të drejtohej kundër personave zyrtarë.²⁸¹ Është e rëndësishme të përmendet se, sipas paneleve të ndryshme, kufizimi i zbatimit të veprës penale vetëm në veprimet e drejtuara ndaj personave zyrtarë do të ishte në kundërshtim me thelbin e veprës penale, që synon të garantojë që detyrat zyrtare të mos pengohen drejtpërdrejt apo tërthorazi.²⁸²

145. Duke qenë se nga interpretimi i thjeshtë i nenit 401(1) të KPK-së është e qartë se qëllimi i ligjvënësit ishte të mbronte kryerjen e papenguar të detyrave zyrtare nga personat zyrtarë dhe jo për të mbrojtur personat zyrtarë në vetvete, Dhoma është e mendimit se interpretimi i dhomave penale ishte në përputhje me formulimin e dispozitës. Gjithashtu, Dhoma vë në dukje se konfirmimi i interpretimit të Trupit Gjykues nga shumica e Panelit të Apelit u bazua në interpretimin sistematik të dispozitës në fjalë, në kontekstin e KPK-së në tërësi. Në veçanti, Paneli i Apelit vuri në dukje se lloji specifik i mbrojtjes në nenin 401(1) të KPK-së nuk përcaktohej në asnjë dispozitë tjetër të KPK-së.²⁸³ Në këtë aspekt, Dhoma gjithashtu vë në dukje se dispozita menjëherë pas saj, përkatësisht neni 402 i KPK-së, përcakton mbrojtje të posaçme për vetë personat zyrtarë.

146. Gjithashtu, Dhoma konstaton se interpretimi i nenit 401(1) të KPK-së prej dhomave penale u mbështet edhe nga shpjeguesi doktrinar në kohën përkatëse të kryerjes së veprës penale. Faktikisht, po ashtu si dhomat penale, edhe kjo Dhomë pranon se Komentari i Ismet Salihut dhe të tjerëve për KPK-në njohu shprehimisht, në kohën e kryerjes së veprës penale, se objekt primar i mbrojtur, sipas nenit 401(1) të

²⁸⁰ Aktgjykimi, para. 146; Aktgjykimi i Apelit, para. 282; Vendimi për Mbrojtje të Ligjshmërisë, para. 40.

²⁸¹ Aktgjykimi i Apelit, para. 282.

²⁸² Aktgjykimi, para. 146; Aktgjykimi i Apelit, para. 282; Vendimi për Mbrojtje të Ligjshmërisë, para. 47.

²⁸³ Aktgjykimi i Apelit, para. 282.

KPK-së, është detyra zyrtare, përkatësisht ushtrimi i papenguar i saj nga ana e personit zyrtar.²⁸⁴

147. Rrjedhimisht, Dhoma është e mendimit se Komentari i Ismet Salihut dhe të tjerëve mbështeti të njëjtin interpretim që i bënë dhomat penale nenit 401(1) të KPK-së, konkretisht se kërcënimi i rëndë mund të drejtohet edhe ndaj personave të tretë apo edhe ndaj një subjekti, nëse u bë me qëllimin për pengimin e kryerjes së detyrave zyrtare nga një person zyrtar.²⁸⁵

148. Rrjedhimisht, Dhoma konstaton se interpretimi i nenit 401(1) të KPK-së prej dhomave penale është në përputhje me formulimin dhe fushëveprimin e dispozitës dhe nuk duket aspak i paarsyeshëm.²⁸⁶ Dhoma gjithashtu thekson se Parashtruesi pati mundësinë t'i paraqiste argumentet e tij mbi interpretimin e nenit 401(1) të KPK-së para tri paneleve të njëpasnjëshme, të cilët i shqyrtuan me kujdes ato. Duke pasur parasysh vendimet e tyre të arsyetuara gjerësisht në lidhje me këtë aspekt dhe duke theksuar se të tri panelet arritën në të njëjtin përfundim,²⁸⁷ Dhoma gjykon se panelet nuk i tejkaluan kufijtë e interpretimit të arsyeshëm të dispozitave përkatëse.²⁸⁸ Për rrjedhojë, interpretimi i dhomave penale është në përputhje me thelbin e veprës penale të përcaktuar në nenin 401(1) të KPK-së dhe veprimet e Parashtruesit logjikisht mund të konsiderohen se përfshiheshin në fushëveprimin e tij.²⁸⁹

149. Sa i përket aspektit nëse interpretimi i dhomave penale ishte logjikisht i parashikueshëm, Dhoma duhet të vlerësojë nëse Parashtruesi logjikisht mund të

²⁸⁴ Ismet Salihu dhe të tjerët, Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (GIZ, 2014) ("Komentari i Salihut dhe të tjerëve"), f. 1165. Megjithëse Komentari i referohet nenit 409(1), Dhoma vë në dukje se kjo është dispozita analoge e nenit 401(1) e ligjit të mëparshëm, përkatësisht e Kodit Penal të Kosovës të vitit 2012, Ligji nr. 04/L-082. Shih gjithashtu Aktgjykimin e Apelit, para. 282.

²⁸⁵ Komentari i Salihut dhe të tjerëve, f. 1165-1166. Shih, gjithashtu, Aktgjykimin, para. 146; Aktgjykimin e Apelit, para. 282; Vendimin për Mbrojtje të Ligjshmërisë, para. 42.

²⁸⁶ ECtHR, *Jorgic v. Germany*, përmendur më lart, para. 104-107.

²⁸⁷ Aktgjykimi, para. 146; Aktgjykimin e Apelit, para. 282; Vendimi për Mbrojtje të Ligjshmërisë, para. 40- 47.

²⁸⁸ ECtHR, *Berardi and Mularoni v. San Marino*, nos 24705/16 24818/16, 10 January 2019, para. 48-52; *K.A. and A.D. v. Belgium*, nos 42758/98 and 45558/99, 17 February 2005, para. 60.

²⁸⁹ Shih Aktgjykimin, para. 536-541, 547, 597-598, 600-605, 646-647, 650, 659-668, 671, 960; Aktgjykimin e Apelit, para. 290-291; Vendimi për Mbrojtje të Ligjshmërisë, para. 42-43.

kishte parashikuar, në kohën e kryerjes së veprës penale, në qoftë se ishte e nevojshme me ndihmën e këshillimit juridik, se rrezikonte të akuzohej dhe dënohej për veprën penale sipas nenit 401(1) të KPK-së dhe se do të vuante dënimin që parashihej për këtë vepër penale.²⁹⁰ Në këtë aspekt, Dhoma thekson se as Parashtruesi, as panelet nuk paraqitën precedentë analogë sipas nenit 401(1) të KPK-së.

150. Sidoqoftë, Dhoma rikujton se sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së, gjatë vlerësimit të parashikueshmërisë së interpretimit juridik nuk duhet t'i kushtohet rëndësi vendimtare mungesës së precedentëve analogë.²⁹¹ Faktikisht mund të krijohen situata në të cilat dhomat penale ftohen ta interpretojnë një dispozitë të së drejtës penale për herë të parë. Si rregull, dhe ndryshe nga situatat që kanë të bëjnë me prapësimin e jurisprudencës së mëhershme,²⁹² interpretimi i kuadrit të veprës penale që ishte në përputhje me thelbin e asaj vepre penale duhet të konsiderohet i parashikueshëm.²⁹³ Në lidhje me këtë, Dhoma rikujton konstatimet e veta në paragrafët 143-148 më lart.

151. Gjithashtu, Dhoma vë në dukje se, në mungesë të jurisprudencës, interpretimi doktrinar i ligjit mund të ketë më shumë peshë, veçanërisht në qoftë se përputhet me interpretimin gjyqësor.²⁹⁴ Dhoma i referohet konstatimeve të veta në paragrafin 146 më lart sa i përket përputhshmërisë së përfundimeve të dhomave penale me interpretimin doktrinar të paraqitur në Komentarin e Ismet Salihut dhe të tjerëve. Gjithashtu, në këtë aspekt, Dhoma vë në dukje se Komentari i KPK-së i Ismet Salihut dhe të tjerëve ishte i qasshëm dhe i disponueshëm për Parashtruesin në shtator 2020, në kohën e kryerjes së veprimeve në fjalë.

²⁹⁰ Shih ECtHR, *Berardi and Mularoni v. San Marino*, përmendur më lart, para. 54; *Jorgic v. Germany*, përmendur më lart, paras 109-113.

²⁹¹ ECtHR, *Berardi and Mularoni v. San Marino*, përmendur më lart, para. 44; *K.A. and A.D. v. Belgium*, përmendur më lart, para. 55; *Soros v. France*, no. 50425/06, 6 October 2011, para. 58.

²⁹² Shih. ECtHR, *Dragotoni and Militaru-Pidhorni v. Romania*, nos 77193/01 and 77196/01, 24 May 2007, paras 42-44.

²⁹³ ECtHR, *Berardi and Mularoni v. San Marino*, përmendur më lart, para. 44; *Jorgic v. Germany*, përmendur më lart, para. 109.

²⁹⁴ ECtHR, *K.A. and A.D. v. Belgium*, përmendur më lart, para. 59. Shih gjithashtu, ECtHR, *Dragotoni and Militaru-Pidhorni v. Romania*, përmendur më lart, para. 43.

152. Në veçanti, Dhoma vëren se, para se të njoftohej për Aktakuzës kundër tij, Parashtruesi dhe përfaqësues ose anëtarë të OVL-UÇK-së u paralajmëruan në mënyrë të përsëritur nga Gjykatësi i Vetëm se veprimet e tyre mund të përbënin vepër penale sipas nenit 15(2) të Ligjit dhe dispozitave të ndryshme të KPK-së të përmendura në të.²⁹⁵ Në lidhje me këtë, Dhoma thekson gjithashtu se, pavarësisht nga kjo, Parashtruesi u përpoq me vetëdije dhe kishte synimin e qartë për të penguar zyrtarët e DHS-së dhe/ose ZPS-së në kryerjen e detyrave zyrtare.²⁹⁶

153. Bazuar në sa më lart, Dhoma nuk mund të pranojë se Parashtruesi, në qoftë se ishte e nevojshme me ndihmën e një avokati, logjikisht nuk mund ta kishte parashikuar se rrezikonte të akuzohej dhe dënohej për veprën penale sipas nenit 401(1) të KPK-së.²⁹⁷ Për rrjedhojë, interpretimi prej dhomave penale i veprës penale të pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare përmes kërcënimit të rëndë, logjikisht mund të konsiderohej se ishte në përputhje me thelbin e asaj vepre penale dhe logjikisht mund të ishte parashikuar nga Parashtruesi në kohën e kryerjes së saj. Rrjedhimisht, Dhoma konstaton se verdikti i fajësisë së Parashtruesit sipas nenit 401(1) të KPK-së nuk përbën shkelje të nenit 33(1) të Kushtetutës dhe nenit 7 të Konventës.

B. PËRFUNDIM

154. Bazuar në sa më lart, Dhoma konstaton se nuk ka pasur shkelje të nenit 33(1) të Kushtetutës dhe të nenit 7 të Konventës.

VIII. KËRKESAT SHOQËRUESE

155. Sa i përket Kërkesës së Parashtruesit për Pranimin e një Prove, Dhoma vë në dukje se Parashtruesi i referohet një letre për të cilën pretendon se do të mbështeste

²⁹⁵ Shih më lart, para. 15.

²⁹⁶ Aktgjykimi, para. 536-541, 547, 597-598, 600-605, 646-647, 650, 659-668, 671, 960; Aktgjykimi i Apelit, para. 290-291; Vendimi për Mbrojtje të Ligjshmërisë, para. 43.

²⁹⁷ Shih, gjithashtu, ECtHR, *Berardi and Mularoni v. San Marino*, përmendur më lart, para. 48-57; *Jorgic v. Germany*, përmendur më lart, para. 109-116.

pretendimet e tij sipas nenit 32(1) të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës.²⁹⁸ Duke kujtuar se ankesa e Parashtruesit në lidhje me këtë aspekt u shpall e papranueshme sipas rregullës 14(f) të DHSGJK-së,²⁹⁹ Dhoma konstaton se Kërkesa e Parashtruesit për Pranimin e një Prove është e tejkualuar. Për të njëjtat arsye, Dhoma konstaton se edhe Kërkesa e Parashtruesit lidhur me Njoftimin e ZPS-së është e tejkualuar.

PËR KËTO ARSYE,

Me vendimin mbi Kërkesën Referuese të z. Nasim Haradinaj, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese njëzëri,

1. *Shpall* të papranueshme ankesën sipas nenit 33(1) të Kushtetutës dhe nenit 7 të Konventës sa i përket nenit 401(1) të KPKS-së, si dhe pjesën tjetër të Kërkesës Referuese;
2. *Konstaton* se nuk ka pasur shkelje të nenit 33(1) të Kushtetutës dhe nenit 7 të Konventës sa i përket nenit 401(1) të KPK-së; dhe
3. *Rrëzon* si të tejkualuar Kërkesën e Parashtruesit për Pranimin e Provës dhe Kërkesën e Parashtruesit lidhur me Njoftimin e ZPS-së.

/nënshkrimi/

Gjykatës Vidar Stensland

Kryegjykatës

Hartuar në anglishte, e premte, 31 maj 2024

Në Hagë, Holandë

²⁹⁸ Kërkesa e Parashtruesit për Pranimin e një Prove, para. 10.

²⁹⁹ Shih më lart, para. 115, 128.